Bombesina (BN) është një neuropeptid i 14 aminoacideve. Ajo është izoluar në mënyrë origjinale nga lëkura e amfibit *Bombina orientalis* dhe është një analog i "gastrin releasing peptide" njërëzore (GRP), që lidhet në receptorët GRP (GRP-R) me afinitet dhe specificitet të lartë [1]. Receptoret GRP janë të pranishëm në disa lloje

tumoresh njërëzore, duke përfshirë kancerin e prostatit, të gjoksit, qeliza të vogla kanceri të mushkërive etj. Ky ndikim i receptoreve të peptideve mbi tumoret njërëzore ka ngjallur intëresin klinik në ditë e sotme. Kështu, është studiuar bombezina e radioshënuar dhe është arritur në përfundimin se ajo mund të përdoret me sukses për shintigrafinë e receptorëve GRP. Akumulimi i lartë i gjurmuesve diagnostikë në tumoret e paoperueshme është kriteri më i rëndësishëm për tërapinë radioizotopike të mëtëjshme.

Mirëpo është vërejtur se bombezina ka një metabolizëm shumë të shpejtë in-vivo dhe si rezultat akumulimi (uptake) në tumore ksenograft në minj është i ulët [5]. Kjo ka rrezikuar përdorimin e saj si radiofarmaceutikat. Por problemi i stabilitetit të ulët in vivo është zgjidhur duke ndërhyrë dhe modifikuar molekulën e bombezinës. Një përmirësim i dukshëm është realizuar nga futja në molekulën e bombezinës të aminoacideve jonatyrële me grupe elektrondhënës, të afta për të kompleksuar ^{99m}Tc e reduktuar [4]. Nga këto ndërhyrje në molekulën e bombezinës janë përfutur disa derivatë, dy prej të cilave i analizuar në këtë studim. Këto derivatë dallohen ndërmjet tyre vetëm nga gjatësia e vargut (pesha molekulare). Struktura e plotë e dy derivatëve është:

(BN1.1): Gly-Gly-Cys-Aca-Gln-Arg-Leu-Gly-Asn-Gln-Trp-Ala-Val-Gly-His-Leu-Met(CONH₂): Gly-Gly-Cys-Aca-BN[2-14]

(BN1.1p): Gly-Gly-Cys-Aca-Gln-Trp-Ala-Val-Gly-His-Leu-Met(CONH₂): Gly-Gly-Cys-Aca-BN[7-14]

MATERIALI DHE METODA

I. Studimet e metabolizmit në veshka dhe mëlçi të homogjenizuara

Ky kontroll është bazuar në përcaktimin e stabilitetit në kohë të kompleksit radioaktiv të krijuar midis derivatëve të bombezinës dhe ^{99m}Tc , të depozituar në veshka dhe mëlçi. Duhet përcaktuar se për sa kohë enzimave të mëlçisë dhe veshkave shkatërrojnë kompleksin e akumuluar në to. Si pasojë e këtij shkatërrimi krijohen specie (pjesë molekulash të peptidit) të reja që lidhen me ^{99m}Tc . Kontrolli kryhet me sistemin e

kromatografisë së lëngët në presion të lartë (HPLC). Bëhet krahasimi i piveve kromatografike, të peptidit të radioshënuar, para dhe pas kryerjes së procedurës dhe në intervale kohe në rritje.

Për të realizuar këtë studim ndiqet kjo procedurë: Sakrifikohen minj normalë me peshë ~20g. Ndahen veç dy veshkat dhe mëlçia dhe homogjenizohen fort me 1ml solucion puferik (TRIS-sukroze, pH=7.4). 100 µl nga solucioni i veshkave dhe 150 µl nga solucioni i mëlçisë të homogjenizuara trajtohen me 150 µl solucion të derivatëve të bombezinës të shënuara me ^{99m}Tc (sipas procedurës së përshkruar më lart) dhe të kontrolluar për pastërti radiokimike me sistemin e kromatografisë së lëngët në presion të lartë HPLC (të përshkruar si më lart). Pas 5 minutash, 15 minutash dhe 30 minutash shtohet në secilin solucion 0.9ml etanol për të ndaluar veprimin e enzimave (ndërpritët reaksioni i shkatërrimit të peptidit) dhe precipitojnë proteinat. Tubat centrifugohen dhe supernatanti i nënshtrohet kontrollit me sistemin e kromatografisë së lëngët në presion të lartë HPLC, pasi është filtruar në një filtër milipor 0.22µm. Për çdo rast përcaktohet përmbajtja (%) e peptidit të pashënuar.

II. Stabiliteti i peptidit të shënuar në plazëm njërëzore

Degradimi (shkatërrimi) i konjugatëve të radioshënuara është studiuar in-vitro si në plazma ashtu dhe në qeliza PC-3. Derivati i bombezinës së shënuar me ^{99m}Tc , është inkubuar në plazmën e dhuruesve të shëndetshëm, në përqendrim 3-4MBq/ml (1.5-2 pmol/ml), në intervale kohe të ndryshme (deri në 24 orë), në 37°C. Pas inkubimit, proteinat janë precipituar me ACN/Etanol 1:1 dhe TFA (0.01%) dhe janë centrifuguar (10 minuta, 20000 rrot/min), në 4°C. Supernatanti është filtruar dhe është analizuar me të njëjtin sistem RP-HPLC si për rendimentin e shënimit të peptidit të shënuar. Për çdo rast është përcaktuar përmbajtja (%) e peptidit të pashënuar.

III. Stabiliteti në qeliza kanceroze PC-3

Stabiliteti në kultura qelizore është vlerësuar me 2×10^6 qeliza kanceroze njërëzore (prostat

adenocarcinoma) PC-3, të siguruara nga European Collection of Cell Culture (Salisbury, England). Qelizat janë ruajtur në ushqyes të tipit DMEM GLUTAMAX-1 me 1-10% FCS, 100 IU/ml penicilin, 100µg/ml streptomycin sulfatë dhe 0.25µg/ml amfotëricin B. Kulturat qelizore janë inkubuar në 37°C në atmosferë që përmban 7.5% CO₂. Këto qeliza i janë nënshtruar rritjes çdo javë, pas shkëputjes së tyre me trypsin/EDTA (0.25%). Derivatët e bombezinës të shënuara me ^{99m}Tc janë shtuar në suspensionin e qelizave, në fosfat bufer saline (PBS), me përqendrim 3-4MBq/ml dhe janë inkubuar në 37°C. Në intervale kohe të ndryshme, deri në 1 orë, qelizat janë bllokuar me anë të precipitimit (siç e përshkruam më lart) dhe janë filtruar. Filtratët janë analizuar me të njëjtin sistem RP-HPLC si më lart. Shumë piqe që u korrespondojnë peptideve të pashkatërruara dhe produktëve të ndryshme të degradimit janë marrë në kromatogramat radioaktive. Përqindja e peptideve të pashkatërruara përcaktohet për çdo kohë inkubimi.

IV. Ritmi i daljes së radioaktivitetit nga qelizat kanceroze

Gjithashtu është studiuar ritmi i lëshimit të radioaktivitetit nga qelizat kanceroze PC-3. Sipas po të njëjtës mënyrë si tek stabilitëti në qeliza kanceroze, është përcaktuar radioaktiviteti i lëshuar nga qelizat kanceroze në funksion të kohës.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

I. Studimet e metabolizmit në veshka dhe mëlçi të homogjenizuara

Rezultatët e marra nga studimet metabolike të stabilitëtit për dy derivatët e bombezinës në veshka dhe mëlçi të homogjenizuar, jepen në grafikun më poshtë.

Shihet qartë nga ky grafik se komplekset e shënuara janë stabël vetëm 5 minuta pas akumulimit në këto organe. Stabilitëti në veshka është pak më i ulët se ai në mëlçi për të dy derivatët. Derivati BN 1.1p jep stabilitët pak më të lartë në të dy organet krahasuar me derivatin BN 1.1.




Figura 1. Metabolizmi në veshka dhe mëlçi të homogjenizuara

II. Stabilitëti i peptideve të shënuara në plazmën njërzore

Studimi i stabilitëtit të dy derivatëve BN1.1 dhe BN1.1p në plazmën njërzore dhe rezultatët e paraqitura grafikisht në Fig. 2.




Figura 2. Stabilitëti në plazmën njërzore

Shihet qartë nga ky grafik, se të dy derivatët kanë stabilitët të lartë në plazmën njërzore, por derivati BN1.1 paraqet stabilitët më të lartë se BN1.1p. Për 120 minuta vetëm 20% e tij është shkatërruar ndërkohë që BN1.1p është shkatërruar në masën 70%.

III. Stabilitëti në qeliza kanceroze PC-3

Me rezultatët e marra lidhur me stabilitëtin e dy derivatëve të shënuara BN 1.1 dhe BN 1.1p, në qeliza kanceroze PC-3 janë ndërtuar grafikët në Fig. 3.




Figura 3. Stabiliteti në qeliza kanceroze PC-3

Grafikët tregojnë qartë se dy derivatët shfaqin stabilitet në qeliza kanceroze. Radioaktiviteti i mbajtur (akumuluar) në to është 75% për BN1.1 dhe 65% për BN1.1p, për 30 minuta.

IV. Ritmi i daljes së radioaktivitetit nga qelizat kanceroze

Studimet e kryera lidhur me ritmin e daljes së radioaktivitetit nga qelizat kanceroze, duke matur radioaktivitetin e qelizave kanceroze në funksion të kohës, çuan në ndërtimin e dy kurbave (për dy derivatët në studim veçmas) të paraqitura në Fig. 4.




Figura 4. Ritmi i daljes së radioaktivitetit nga qelizat kanceroze

Duke analizuar dy kurbat e këtij grafiku, nuk vihet re mbajtje për një kohë të gjatë e radioaktivitetit nga qelizat kanceroze (afërsisht 4 ore), për të dy derivatët e studiuar, ndërkohë që 4 orë është një kohe e mjaftueshme për të kryer të gjitha

procedurat e marrjes së imazheve shintigrafike [6].

PËRFUNDIME

Rezultatët e këtij studimi tregojnë se të dy derivatët e bombezinës shfaqin veti biologjike të ngjashme me ato të bombezinës natyrore dhe kanë këto veti premtuese për t'u përdorur si një radiofarmaceutikat specifik i ri për zbulimin e tumoreve:

1. Studimet metabolike tregojnë stabilitet të ulët në veshka dhe mëlçi, të homogjenizuar për të dy derivatët në studim
2. Studimet in vitro të degradimit të dy koniugatëve të radioshënuara tregojnë stabilitet të lartë në plazmën njërëzore dhe qeliza kanceroze.
3. Studimi i ritmit të daljes së radioaktivitetit nga qelizat kanceroze tregon për mbajtje 4 orë të lëndës radioaktive në këto qeliza, kohë kjo optimale për të kryer studimet shintigrafike.
4. Krahasimet midis derivatëve BN1.1 dhe BN1.1p tregojnë për përmirësim të sjelljes radiofarmakologjike të derivatit BN1.1p, gjë që i jep atij mundësinë për t'u përdorur me sukses si radiofarmaceutikati më i përshtatshëm në diagnostikimin e kancerit në pankreas.

BIBLIOGRAFIA

1. Costopoulos B., Varvarigou A.D., Sivolapenko G., Potamianos S., Scopinaro F. and Archimandritis S.C. Radiochemical and radiobiological evaluation of a synthetic peptide labelled with ^{99m}Tc . *Nucl. Med. Commun.* 18, 474-481. (1997).
2. Karra S.R., Schibli R., Gali H., Katti K.V. and Hoffman T.J., Higginbotham Sieckman GL, and Volkert WA. ^{99m}Tc -labeling and in vivo studies of a bombesin analogue with novel water-soluble dithiadiphosphine-based bifunctional chelating agent. *Bioconjug Chem*, 10, 254-260, (1999).
3. La Bella R., Garcia-Garayoa E., Langer M., Blauenstein P., Beck-Sickinger A.G. and Schubiger PA. In vitro and in vivo evaluation of a ^{99m}Tc (I)-labeled bombesin analogue for imaging gastrin releasing peptide receptor-positive tumors. *Nucl Med Biol*, 29, 553-560, (2002).

4. Mantey S., Frucht H., Coy D.H., and Jensen R.T. Characterization of Bombesin Receptors Using a Novel, Potent, Radiolabeled Antagonist That Distinguishes Bombesin Receptor Subtypes. *Molecular Pharmacology*. 43, 762-774, (1993).
5. Nock B., Nikolopoulou A., Chiotellis E., Loudos G., Maitas D., Reubi J.C. and Maina T. [99mTc]Demobesin 1, a novel potent bombesin analogue for GRP receptor-targeted tumor imaging. *Eur J Nucl Med*. 30, 247-258, (2003).
6. Van de Wiele C., Dumont F., Vanden Broecke R., Oostérinck W., Cocquyt V., Serreyn R., A GRP analogue for visualisation of GRP receptor-expressing malignancies: a feasibility study. *Eur J Nucl Med*, 27, 1694-1699, (2000).
7. Ulderico Mazzi, Technetium, Rhenium and other metals in Chemistry and Nuclear Medicine, 7, september 2006.

PËRGATITJA DHE KONTROLLI I CILËSISË SË RADIOFARMACEUTIKATIT ⁹⁰Y-CITRAT PREPARATION AND QUALITY CONTROL OF THE ⁹⁰Y-CITRAT RADIOPHARCEUTICAL

ELIDA BYLYKU, BRUNILDA DACI, SKENDER MALJA
Qendra e Fizikes Berthamore të Zbatuar, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Rruga "Qesarake", Kutia Postare 85, Tiranë, Shqipëri
Email: elidabylyku@yahoo.co.uk

AKTET IV, 1: 35 - 40, 2011

PËRMBLEDHJE

Ky studim i referohet një metode relativisht të thjeshtë dhe të shpejtë për të përgatitur radiofarmaceutikatin ⁹⁰Y-citrat. Kemi përmirësuar dhe modifikuar procedurën e publikuar më parë duke konvertuar solucionin e ekstraktuar në forme klorure (⁹⁰Y-Cl₃), i përdorur për përgatitjen e solucionit të injektueshëm ⁹⁰Y-citratë dhe shënimin e disa radiofarmaceutikatëve të tjerë. Eshtë realizuar kontrolli i cilësisë së solucionit ⁹⁰Y-citratë. Eshtë kontrolluar pastërtia radiokimike, pastërtia kimike, rrjedhja e ⁹⁰Sr dhe rendimenti i ekstraktimit. Për të kontrolluar pastërtinë radiokimike është zbatuar metoda ITLC në sistemin ITLC-SG / 0.1 M TRIS. Pastërtia kimike është kontrolluar duke përdorur metodën Hnatovich, ndërsa rrjedhja e ⁹⁰Sr dhe rendimenti i ekstraktimit duke përdorur metodën e shintilatorëve të lëngët. Rezultatët treguan se ky produkt plotëson të gjitha kërkesat për përdorim si radiofarmaceutikat.

Fjalë kyçe: Pastërti kimike, radiofarmaceutikat, radioizotop, rendiment ekstraktimi, rrjedhja e ⁹⁰Sr, ⁹⁰Y-citrat.

SUMMARY

The current study refers to a relatively simple and fast method to prepare radiopharmaceutical ⁹⁰Y-citratë. We have improved and modified previously published procedure converting into chloride form ⁹⁰YCl₃-solution, used for preparing of injectable ⁹⁰Y-citratë and labeling of some other radiopharmaceuticals. Quality control of ⁹⁰Y-citratë solution is performed. It is checked radiochemical purity, chemical purity, ⁹⁰Sr breakthrough and extraction yield. The Instant Thin Layer Chromatography (ITLC) method in ITLC-SG / 0.1 M TRIS system it is applied to check radiochemical purity. Chemical purity is checked by using of Hnatovich method, while ⁹⁰Sr breakthrough and extraction yield using Liquid Scintillation Method. This radiopharmaceutical fulfills all requirements for radiopharmaceuticals in general.

HYRJE

Bazuar në parimin e funksionimit të gjeneratorit izotopik ⁹⁰Sr-⁹⁰Y, pas një intervali kohor prej afërsisht dy javësh, radioizotopet ⁹⁰Sr dhe ⁹⁰Y ndodhen në të ashtuquajturin ekuilibër shekullor, pra me aktivitetet të barabarta edhe pse janë në sasi të ndryshme. Ideja e një gjeneratori është ndarja (largimi) e radioizotopit bijë (⁹⁰Y) nga ai mëmë (⁹⁰Sr), pas arritjes së këtij ekuilibri, dhe prodhimi nga ana e radioizotopit mëmë e sasive të reja të radioizotopit bijë. Ekzistojnë shumë metoda të rekomanduara në literaturë që

përshkruajnë ndarjen e këtyre dy izotopeve, duke filluar nga metodat e precipitimit, ekstraktimit me solvent, jonokëmbimit e deri tek metoda e jonokëmbimit në membranë. Më të rëndësishmet dhe më të përdorshmet mbetën metodat e ekstraktimit dhe jonokëmbimit. Zakonisht metodat e kromatografisë së jonokëmbimit përdoren kur shfrytëzohen aktivitetet deri në nivele MBq ndërsa metodat e ekstraktimit me solvent shfrytëzojnë aktivitetet deri në nivele GBq, kjo për shkak të efektit të radiolizës së rezinës që përdoret në metodat

kromatografike. Ekziston një përvojë e gjatë pune lidhur me ndërtimin e gjeneratorëve kromatografikë ^{90}Sr - ^{90}Y . Megjithëse këta gjeneratorë janë shumë të thjeshtë në përdorim dhe për këtë kanë marrë përhapje të gjerë, problemi kryesor i tyre mbetet jetëgjatësia.

Duke pasur parasysh rëndësinë e përdorimit të solucionit ^{90}Y -citrat të prodhuar nga gjeneratori ^{90}Sr - ^{90}Y dhe të radiofarmaceutikatëve tërapiutike që prodhohen nga shënimi me ^{90}Y për tërapiutë e sëmundjeve kanceroze u ndërmor ky studim me objektivin e përgatitjes së solucionit ^{90}Y të marrë nga gjeneratori në trajtë acidi dhe kalimin e tij në trajtë radiofarmaceutikati ^{90}Y -citrat të gatshëm për t'u përdorur për tërapi në pacientë me metastaza kanceroze.

Solucionet e marra pas ekstraktimit u kontrolluan për pastërtinë radiokimike (përcaktimi i rendimentit të shënimit), radiobërthamore (përmbajtja e ^{90}Sr nuk duhet të kalojë vlera limitë të përcaktuara kur solucion përdoret për qëllime klinike) dhe kimike (përmbajtja e joneve metalike dy dhe tre valentë që shoqërojnë ^{90}Y si: Fe^{+3} , Zn^{+2} , Cu^{+2} , Zr^{+2} , etj., kur solucion përdoret për shënimin e biomolekulave sensitive) [5].

MATERIALI DHE METODA

1. Përgatitja e solucionit të jonit $^{90}\text{Y}^{3+}$

^{90}Y i ndarë nga solucion ^{90}Sr - ^{90}Y , si rezultat i procesit të ekstraktimit me 8-hidroksikolinë të tretur në kloroform, është në trajtë kompleksi. Në gjendje të tillë ai nuk mund të përdoret për shënimin e komponimeve të ndryshme dhe as për qëllime tërapiutike si radiofarmaceutikat. Ai duhet kaluar në formë jonike si $^{90}\text{Y}^{3+}$. Pra duhet realizuar "ekstraktimi i kthimit" të tij në gjendjen fillestare (siç ndodhet në solucionin ^{90}Sr - ^{90}Y). Për këtë është i nevojshëm shkatërrimi i kompleksit, të krijuar midis tij dhe 8-hidroksikolinës. Për të realizuar këtë kalim u përdor solucion 0.01N HCl në vëllim 1:1 me fazën organike të marrë nga procesi i ekstraktimit (që përmban kompleksin e ^{90}Y me 8-hidroksikolinë). Dy fazat iu nënshtruan procesit të ekstraktimit (përzierje 30 minuta, centrifugim 5 minuta 3000rrot/min, ndarje fazash, përcaktimi i pastërtisë radiokimike të secilës faze dhe i shkallës së ekstraktimit [7]).

2. Përcaktimi i pastërtisë kimike të solucionit të $^{90}\text{Y}^{3+}$

Përmbajtja e joneve të metaleve dy dhe tre valentë është parametër i rëndësishëm i cilësisë së solucionit të $^{90}\text{Y}^{3+}$, veçanërisht kur përdoret për shënimin e antitropave dhe aminoacideve në të cilët është bashkuar agjenti DTPA. Sasia e metaleve gjurmë duhet mbajtur sa më e ulët të jetë e mundur që të merren rendimentë sa më të larta shënimi të këtyre biomolekulave sensitive. Në procesin e shënimit të antitropave ose të somatostatinës në të cilët është e lidhur DTPA, prania e joneve të metaleve gjurmë në mjedisin e shënimit çon në konkurimin e joneve të metaleve joradioaktive me ^{90}Y për vende lidhjeje me DTPA, duke rezultuar kështu në një rendiment shënimi të ulët [3]. Në përputhje me metodikën Hnatovich, efekti i metaleve gjurmë mund të matët duke përcaktuar rendimentin e shënimit në solucione me përqëndrime shumë të ulëta të DTPA së lirë në prani të ^{90}Y [4].

Mënyra e veprimit

Në enë të vogla plastike u hodh 100 μl nga secili solucion i DTPA i përgatitur si më lart dhe në secilin nga to u shtua nga 1 μl solucion radioaktiv i ^{90}Y të përgatitur siç është treguar më lart (i gatshëm për shënim). Pas 2 orësh analizojmë secilin solucion duke zhvilluar kromatografi në letër Whatman 1Chr dhe duke përdorur si eluent 0.1M TRIS në pH = 7. Në këtë sistem kompleksi ^{90}Y -DTPA migron me frontin, ndërsa ^{90}Y i lirë qëndron në origjinë [1].

3. Përcaktimi i rendimentit të ekstraktimit të ^{90}Y dhe rrjedhjes së ^{90}Sr

Përcaktimi i rendimentit të ekstraktimit (shkalla absolutë e ekstraktimit) dhe përmbajtja e sasive gjurmë të ^{90}Sr në solucionin e $^{90}\text{Y}^{3+}$, të përgatitur siç u përshkrua më lart, u realizua me metodën e spektrometrisë së shintilatoreve të lëngët.

Procedura e përcaktimit

β -zbërthimi i ^{90}Sr dhe ^{90}Y është matur më anë të numëruesit me shintilatorë të lëngët të tipit TRI-CARB 1600TR (Packard-Canberra).

Kushtet e matjes:

		Zonat energjetike		Rajoni C	25	1000	$^{90}\text{Sr} + ^{90}\text{Y}$
Rajoni A	25	250	$^{90}\text{Sr} + \text{Rajoni i energjisë së ulët të } ^{90}\text{Y}$	Koha e matjes:	1 minutë.		
Rajoni B	250	1000	Rajoni i energjisë së lartë të ^{90}Y				




Figura 1. Kromatogramat e skanuara për një cikël të plotë ekstraktimi




Figura 2. Kromatogramat e skanuara për përqëndrime të ndryshme të DTPA-së

Përcaktimi i rendimentit të ekstraktimit të ^{90}Y

U përgatitën një seri mostrash nga solucioni në ekuilibër ^{90}Sr - ^{90}Y , u matën me shintilatorë të lëngët (metoda Cerenkov) në intervalet e energjisë të përcaktuar nga kalibrimi i aparaturës. Nga matjet e kryera u llogarit përmbajtja e ^{90}Y në to. Më pas secili prej solucioneve iu nënshtrua procesit të ekstraktimit deri në fazën e nxjerrjes së $^{90}\text{Y}^{+3}$. Solucionet e marra që përmbajnë ^{90}Y dhe gjurmë të ^{90}S janë matur në të njëjtën mënyrë si përzjerja në ekuilibër dhe është llogaritur aktiviteti i ^{90}Y në to.

Përcaktimi i rrjedhjes së ^{90}Sr

Rrjedhja (përmbajtja në sasi gjurme) e ^{90}Sr në solucionet e $^{90}\text{Y}^{+3}$, kur ato përdoren për terapi në pacientë me metastaza kanceroze në kocka, është një parametër shumë i rëndësishëm i kontrollit të kualitetit të këtyre solucioneve (kemi parasysh këtu radiotoksicitetin shumë të lartë të shkaktuar nga ai). Ekzistojnë norma kufi të vendosura lidhur me përmbajtjen e ^{90}Sr në këto radiofarmaceutikate [6].

Për të përcaktuar përmbajtjen e ^{90}Sr në solucionet e $^{90}\text{Y}^{+3}$, u lanë një seri mostrash të tyre për t'u zbërthyer për një kohë prej 10 perida gjysmëzbërthimi të ^{90}Y (26 ditë). Më pas u mat dhe u llogarit aktiviteti i seciles prej tyre, sipas procedurës së përshkruar më lart me metodën e

spektrometrisë së shintilatorëve të lëngët. $\frac{1}{2}$ e këtij aktiviteti jep përmbajtjen e ^{90}Sr në këto solucione (pas 26 ditësh ^{90}Sr dhe ^{90}Y ndodhen përsëri në ekuilibër radioaktiv).

4. Përgatitja e radiofarmaceutikut ^{90}Y -citrati

Solucioni radioaktiv që përmban $^{90}\text{Y}^{3+}$ në 0.01N HCl nuk mund të përdoret direkt si radiofarmaceutikat për qëllime terapeutike. Ai duhet t'i nënshtrohet një përpunimi kimik për të kaluar në formën kimike të përshtatshme për t'u pranuar nga organizmi i njeriut. Ky përpunim përmbledh këto faza:

Avullim shumë i ngadaltë (për të mos krijuar humbje të radioaktivitetit dhe ndotje) i solucionit deri në të thatë

Djegje dhe trajtim me disa pika H_2O_2 , HNO_3 dhe HClO_4 , me alternim (për të shkatërruar mbeturinat organike të pranishme në fazat e ekstraktimit)

Mbetja e fundit trajtohet me 3ml solucion citrati izotonik (11.4mM $\text{Na}_3\text{citrati} \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ dhe 77mM NaCl)

Lihet të qëndrojë për rreth 10 minuta për të përfunduar reaksioni i plotë

Filtrohet në mënyrë aseptike në një filtër steril milipor 0.22 μm

Solucioni i gatshëm rekomandohet të ruhet në frigorifer (-4°C) deri në përdorim.

Ky solucion mund të përdoret për trajtimin e dhimbjeve të shkaktuara nga metastazat e kockave duke u injektuar intra-venoz në një dozë prej 5-10mCi [2], pasi i është nënshtuar kontrollit të kualitetit për pastërtinë radiokimike dhe përmbajtjen e ^{90}Sr të përshkruar si më lart.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

1. Përgatitja e solucionit të jonit $^{90}\text{Y}^{3+}$

Rezultatet e marra nga disa prova paralele treguan për një ekstraktim (kalim) pothuajse të plotë të ^{90}Y nga faza organike (ku ndodhet si kompleks) në fazën ujore (si jon $^{90}\text{Y}^{3+}$). Shkalla e ekstraktimit në të gjitha rastet është mbi 98%. Por analiza radiokromatografike e solucionit përfundimtar që përmban ^{90}Y tregon për ekzistencën e dy piqueve kromatografike.

Dyshimet për praninë e ^{90}Sr bien menjëherë pas skanimit të së njëjtës kromatogramë me ekranizim të plotë për ^{90}Sr . Fakti që piku i dytë nuk zhduket, me ekranizim të plotë të kromatogramës, tregon për mungesë të tij. Si përfundim mund të themi që shkatërrimi i kompleksit ^{90}Y - 8-hidroksikonoline me 0.01N HCl çon në formimin e dy komponimeve të $^{90}\text{Y}^{3+}$. Në këtë përfundim u arrit pas kryerjes së një serie procedurash paralele dhe marrjes së rezultateve të përsëritura. Kromatogramat e skanuara për një cikël të plotë procesi ekstraktimi deri në fazën e marrjes së $^{90}\text{Y}^{3+}$ jepen në Fig. 1.

2. Përcaktimi i pastërtisë kimike të solucionit të $^{90}\text{Y}^{3+}$

Kromatogramat e skanuara për përqëndrimet 1; 0.1 dhe 0.01 μg DTPA / 100 μl solucion, jepen në Fig. 2. Përveç kësaj, zhvillojmë edhe kromatografinë e solucionit të ^{90}Y të patrajtuar me DTPA, për të na ndihmuar në gjykim.

Duke analizuar kromatogramat gjykojmë që në rastin e solucionit pa DTPA shfaqet vetëm piku i ^{90}Y . Në solucionin me përqëndrim 0.01 μg DTPA / 100 μl fillon të shfaqet piku i ^{90}Y -DTPA. Ky pik është më i theksuar në solucionin me përqëndrim 0.1 μg DTPA / 100 μl . Në solucionin me 1 μg DTPA / 100 μl shihet që arrihet rendiment shumë i lartë shënimi i DTPA me ^{90}Y , kompleksi ^{90}Y -DTPA arrin në rreth 90%.

Si përfundim mund të themi se solucioni i $^{90}\text{Y}^{3+}$, i përgatitur për shënim biomolekulash përmban gjurmë të joneve metalike 2 dhe 3 valentë. Është e domosdoshme që solucionin e ^{90}Y të pastrohet nga gjurmët e kationeve që e shoqërojnë atë si papastërti. Për pastrim, solucionin kalohet në një kollonë jonokëmbyese (të përgatitur me rezinë që ka afinitet për të mbajtur jonet metalike dhe ^{90}Y). Nga kjo kollonë eluohet ^{90}Y me eluent specifik për të.

3. Përcaktimi i rendimentit të ekstraktimit të ^{90}Y dhe rrjedhjes së ^{90}Sr

Nga matjet e kryera është llogaritur rendimenti i ekstraktimit të ^{90}Y me formulën:

$$\text{Rendimenti i ekstraktimit të } ^{90}\text{Y} (\%) = A_Y / A_{\text{Sr-Y}}$$

ku: A_Y është aktiviteti i ^{90}Y në solucionin e marrë pas fazës së plotë të ekstraktimit

$A_{\text{Sr-Y}}$ është aktiviteti i ^{90}Y në solucionin në ekuilibër ^{90}Sr - ^{90}Y .

Rezultatet e marra nga kjo metode, si mesatare e një serie mostrash paralele, treguan se rendimenti i ekstraktimit të ^{90}Y (ose shkalla absolute e ekstraktimit) nga solucionin në ekuilibër ^{90}Sr - ^{90}Y është 81%. Ky rendiment përfaqëson rendimentin e reaksionit kimik të kompleksoformimit të ^{90}Y me 8-hidroksikinolinin, rendimentin e procesit të ekstraktimit dhe humbjet e shkaktuara si pasoje e absorbimit të ^{90}Y në faqet e enëve të qelqit që përdoren për ekstraktim dhe ndarje fazash.

Rezultatet e marra nga metoda e përdorur për përcaktimin e rrjedhjes së ^{90}Sr , treguan se përmbajtja e ^{90}Sr në këto solucione nuk kalon në asnjë rast kufirin maksimal të lejuar $^{90}\text{Sr} / ^{90}\text{Y} < 10^{-6}$.

PËRFUNDIME

Përfundimet më të rëndësishme të arritura nga ky studim janë:

1. Mbi bazën e gjithë punës studimore të kryer, lidhur me mundësinë e përgatitjes së solucionit të ^{90}Y -citrat për qëllime terapeutike ose për shenim biomolekulash, arrihëm në përfundimin se ky preparat plotëson të gjitha kërkesat e përdorimit si radiofarmaceutikat.
2. U përcaktua procedura optimale për përgatitjen e solucionit të $^{90}\text{Y}^{+3}$ të gatshëm për shenim biomolekulash dhe përdorim në radioterapi.
3. U përcaktua rendimenti mesatar i ekstraktimit të ^{90}Y sipas procedurës së propozuar, 81%.

4. Përmbajtja e ^{90}Sr në solucionet e përdorura për radioterapi në pacientë në asnjë rast të analizuar nuk kalon vlerat kufi të lejuara.

5. Kontrolli i pastërtisë kimike tregoi për pastërti të lartë kimike të preparatit radiofarmaceutik përse i perket joneve të metaleve dy dhe tre valentë.

BIBLIOGRAFIA

1. Malja, S. A fast chromatographic method for separation and determination of ^{90}Sr in ^{90}Y elute. *Fifth Balkan Physical Society Meeting*, SP 15-021, 25-28 August 2003, Vrnjacka Banja, Serbia.
2. Malja S. Labeling of MDP with ^{90}Y . *J.N.S.T.*, 5, 1999.
3. Malja S. Preliminary results on labeling antibody Mab B72.3 with ^{90}Y . *J.Radioanal. Nucl. Chem.*, Letters 218, (2), 1997.
4. Malja S. Preliminary results on labeling tetrasulphonil-porphyrin with ^{90}Y . *Albanian Journal of Natural & Technical Science*. No. 6 (2000), 81-87.
5. Malja S. Preparation of ^{90}Y by the ^{90}Sr - ^{90}Y generator for medical purpose. *Journal of Radioanalytical and Nuclear Chemistry.*, *J.Radionalytical and Nuclear chemistry*, Vol. 245, No 2 (2000) 403-406.
6. Malja S. Some aspects of the Sr-90-Y-90 generator production and development of a new quality control method. *The Society of Nuclear Medicine 44th Annual Meeting*, San Antonio Convention Centre, 1-5 June 1997.
7. Malja S. Some preliminary results on labeling of 1-hydroxyethylenediphosphonic acid with Y-90. ISTR-2005, IAEA-CN-130/120, Vienna 2005.

PËRCAKTIMI I TRIAZINAVE ME PËRDORIMIN E TIROZINAZËS OPEE DUKE VEPRUAR NË KLOROFORM

DALINA LELO¹, LUIGI CAMPANELLA¹, GJERGJI MERO², ALBAN YLLI³

¹Universiteti i Romes "Sapienza", Departamenti i Kimisë, Romë, Itali

²Universiteti Fan S. Noli, Korçë, Shqipëri

³Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri

Email: dalina.lelo@uniroma1.it

AKTET IV, 1: 41-47, 2011

PËRMBLEDHJE

Në vitet e fundit janë vënë re zhvillime të shpejta në OPEE (Elektrodë enzimë në fazë organike) biosensor, emri i të cilit është në funksion të solventit organik dhe solventit të përzierë. Një biosensor enzimë i ndërtuar është ai që bazohet mbi tirozinazën. Ne kemi ndërtuar një model biosensori nëpërmjet të cilit vepohet në solucion ujor dhe një që vepohet në solvent organik [1, 2]. Ky biosensor përbëhet nga një transdutor amperometrik i oksigjenit në të cilin vihet enzima e tirozinazës në të cilën imobilizohet xheli kappa-karraginin. Me përdorimin e tij është bërë e mundur të kryhen analiza në produkte ushqimore si dhe në fushën e mjedisit. Në mënyrë të veçantë për këtë qëllim janë përdorur pesticidet triazinike si dhe inhibimi i tyre nga enzima tirozinazë. Kërkimet e fundit në laboratorin tonë [3, 4] kanë treguar vlerën e këtyre biosensoreve qoftë kur përdoret enzima e inhibicionit OPEE në rastin e pesticideve organofosforike [5, 6] apo atyre karbamate, qoftë kur ata përdoren në solucione të tretëshme apo ato ujore. Shumë prej tyre, si për shembull atrazinat, janë shumë të tretëshme në fazë organike si metanol dhe kloroform. Këto metoda të analizës janë të thjeshta, praktike dhe të shpejta. Për këtë qëllim po punohet që edhe në të ardhmen metoda të tilla të aplikohen në kushtet konkrete të Shqipërisë.

Fjalë kyçe: Tirozinazë biosensor OPEE, solvent organik e ujor, ushqime

HYRJE

Pesticidet janë lëndë kimike të sintezës që përdoren në bujqësi për të luftuar tipe të ndryshme të organizmave të dëmshme në mbjelljen e produkteve bujqësore.

Përdorimi i mëtejshëm i këtyre produkteve ka lejuar arritje në nivel të lartë të prodhimit të produkteve bujqësore. Për këtë qëllim shpesh janë injoruar efektet e tyre në ekosistem. Interesi i lartë për metodat e analizës që evidentojnë me shpejtësi mbetjet e pesticideve në ambient apo ushqime është shtuar shumë kohët e fundit sepse këto substanca janë përgjegjëse të shumë sëmundjeve për shkak të disfunktionimit të organizmit human, dhe mbi të gjitha ato

shkaktojnë "biogrubullim" për shkak të rezistencës së lartë në ambient të disave prej tyre. Deri tani janë zhvilluar një numër i madh metodash sidomos ato kromatografike të cilat shërbejnë për të analizuar tipe apo grupe të ndryshme të pesticideve [7, 8].

Një kontribut të vazhdueshëm kanë dhënë metodat biosensorike, të cilat janë studiuar dhe zbatuar që prej shumë vitesh por mbi të gjitha duhet vënë në dukje studimi i grupeve të pesticideve si triazinave, organofosforeve dhe karbamateve. Ky studim përshkruan aplikimin e metodave biosensorike dhe në mënyrë të veçantë biosensor i tirozinazës për përcaktimin e tre tipeve të pesticideve triazinike:

Biosensori i përdorur në këtë rast quhet OPEE (Organic Phase Enzyme Electrodes) dhe funksionon në dy faza: faza organike dhe ajo e përzierë [24-26]. Ky fakt përbën një përparësi shumë të rëndësishme për sektorin biosensorik. Një shembull biosensori enzimatik që ka përparësi në krahasim me të tjerët është ai që bazohet në enzimën e tirozinazës. Në këtë studim kemi prezantuar një model të këtij biosensori që vepron në dy fazat e përmendura më lart. Ky biosensor është i përbërë nga një transdutor amperometrik i oksigjenit në të cilin vendoset enzima e tirozinazës dhe mund të përdoret për analiza të ushqimeve apo edhe në fusha të ndryshme të ambientit. Në mënyrë të veçantë një biosensor i tillë gjen zbatim për kontrollin e përqendrimit të polifenoleve dhe pastërtisë së vajit të ullirit. Kërkimet e fundit qoftë në laboratorin tonë [9, 10] dhe në laboratorë të tjerë tregojnë vlerën e këtij tipi biosensori të përdorur, që bazohet në inhibimin e butirrikolinesterazës dhe tregon se pesticidet triazinike janë shumë të tretshëm në faze organike, në mënyrë të veçantë në kloroform. Ky studim ka si qëllim zbatimin e analizave të tilla në pesticide të grupit triazinik nëpërmjet tirozinazë OPEE dhe që funksionon në një sistem organik tretës.

PJESA EKSPERIMENTALE

1. Reaktivë dhe materiale

Atraton, atrazinë, atrazinë-desetil (Pestanal Sigma-Aldrich), kloroform RPE, diklorometan RPE, kalium fosfat dybazik e njëbazik anidro RPE (Carlo Erba Reagent); klorur kaliumi (Riedel-de Haen)

(Seelze, Germania); Fenol, Membrane dialize (art.D-9777) (Sigma-Aldrich); Kappa-Carraginin dhe Tirozinase (EC 1.14.18.1) nga kerpuhua 3216 U/mg (Fluka).

2. Aparati

Për të analizuar pesticidet triazinike është përdorur një potenciostat tip Amel mod. 551 VA-Detektor, i lidhur me një multimetër MK 5001, të Mitek, një regjistrator analogjik Omniscrite Recorder, mod. d5126-2, e një elektrodë amperometrik për oksigjenin të Universal Sensor Inc., New Orleans (U.S.A.), Mod. 4000-1.

Soluzioni që duhet analizuar ndodhet në një gotë kimike të termostatuar në 24°C si dhe i mbajtur në levizje nepermjet një perziesi manjëtik (Amel Instruments: mod. 291/lf).

3. Metoda e përdorur

Është përdorur një biosensor i tirozinazës për përcaktimin dhe inhibimin enzimatik të quajtur OPEE i cili shërben për të përcaktuar pesticide me strukture triazinike. Një biosensor i tillë është realizuar duke përdorur enzimen e tirozinazës të mbeshtjelle në xhelin e kappa-karragininës. Xheli është vendosur në kontakt me një membranë gas e pershueshme në kapakun e PTFEE të elektrodës TIP Klark që shërben si transdutor (shndërrues transportator i sinjalit). Membrana e xheliformes mbahet në anesor nepermjet një rrjetë najloni dhe një rrethi plastik që e fikson membranën përreth kapucit. Erbicidet triazinike që janë përdorur për këtë studim janë paraqitur në figurën 1:




Figura 1: Tre pesticidet e përdorura për studim

a). Imobilizimi i enzimës në xhel të Kappa-karragininës

Enzima e tirozinazës (3216 U/mg) është peshuar (3,75 mg) e tretet në 100 μl tampon fosfati 0,06 mol l^{-1} , a pH = 6,6. Solucioni i përgatitur në këtë mënyrë është gati për të ndajthitur një disk të xhelit të Kappa-karragininës e cila lihet në frigorifer për 48 orë, përpara se të përdoret.

b) Ndërtimi i lakores së kalibrimit

Në këtë rast janë zbatuar dy procedura të ndryshme për kryerjen e analizave të cilat janë aplikuar dhe treguar në shumë punime shkencore mbi fito barnat [10, 13, 39, 42].

c). Metoda e parë e përdorur

Ne një gotë kimike të termostatuar që përmban 10mL tretës organik (kloroform të ngopur me H_2O) vihet ne perzjerje të vazhdueshme nepermjet perzjeresit manjëtik. Biosensori i përgatitur si me lart zhytet ne soluzion derisa të arrihet një sinjal i qendrueshem. Mbas ketij veprimi shtohen 200 μl të një solucioni të fenolit $2,5 \times 10^{-2} \text{ mol l}^{-1}$ ne kloroform të ngopur me H_2O , regjistrohët ndryshimi i sinjalit ne nA. Ne momentin kur arrihet stadi stazionar i ri, atëhere kryhen shtesa të vazhdueshme 200 μl , të solucionit të atrazinës (o të një pesticidi tjetër triazinik në kloroform të ngopur me ujë), për përqëndrime të ndryshme. Përqëndrimet e përdorura në këtë rast janë: $1,0 \times 10^{-4} \text{ mol l}^{-1}$, $1,0 \times 10^{-3} \text{ mol l}^{-1}$, $1,0 \times 10^{-2} \text{ mol l}^{-1}$. Nga njëra shtesë te tjetra pritet një kohë e caktuar e nevojshme për stabilizimin e sinjalit (rreth 15 minuta).

Për ndërtimin e lakores së kalibrimit në abshisë shënohet përqëndrimi final i atrazinës në gotën kimike, ndërsa në ordinatë Δi (ose $\Delta i \%$), ku:

$$\Delta i \% = [1 - (S_c - S_d)] / S_c \times 100 \quad (1)$$

S_c = ndryshimi i intensitetit të korrentit për shkak të shtimit të fenolit

S_d = ndryshimi i intensitetit të korrentit për shkak të shtimit të pesticidit, figura 2.




Figura 2: Metoda 1




Figura 3: Metoda 2




Figura 4: Optimizimi substraktit

d). Optimizimi i përqëndrimit të substraktit që duhet përdorur në matjet me inhibicion

Optimizimi i përqëndrimit të substraktit që përdoret ne matjet me inhibicion është realizuar duke regjistruar % e inibimit të përgjigjes se biosensorit me tirozinase ne funksion të përqëndrimit të fenolit ne soluzionin ku është zhytur biosensori për një përqëndrim të caktuar të atrazines se shtuar. Për këtë qëllim janë kryer matje ne përqëndrime ne rritje të fenolit (substrakti) ne kloroform të ngopur me uje: ($5,0 \times 10^{-3} \text{ mol l}^{-1}$, $2,5 \times 10^{-2} \text{ mol l}^{-1}$ e $5,0 \times 10^{-2} \text{ mol l}^{-1}$), për një përqëndrim të caktuar të atrazines (inhibitore) $1,0 \times 10^{-3} \text{ mol l}^{-1}$. Praktikisht, ne një gotë kimike që përmban 10 ml të kloroformit të ngopur me uje, perzihet ne mënyrë kostante nepermjet perzjeresit manjëtik zhytet biosensori,

i mbeshtjelle sic është pershkruar me lart, pritet stabilizimi i sinjalit. Ne rastin kur arrihet stadi i ri stacionar shtohen 200 µl të atrazines ($1,0 \times 10^{-3}$ mol $^{-1}$), regjistrohet një ndryshim i ri i sinjalit ne nA. Përqindja e inhibimit të përgjigjes arrihet nepermjet ekuacionit të pershkruar ne paragrafin më lart.

Përsëritja e procedurës për përqëndrime të ndryshme të fenolit bën të mundur ndërtimin e lakores së kalibrimit që tregon përgjigjen e biosensorit për një sasi të caktuar të pesticidit dhe për përqëndrime në rritje të substraktit (fenolit). Çdo procedurë është përsëritur disa herë duke përdorur një përqendrim fiks të atrazinës (për shembull 1×10^{-4} mol $^{-1}$ od una 1×10^{-2} mol $^{-1}$), Figura 4.

e). Metoda e dytë e perdorur

Në metodën e dytë operative, në ndryshim me atë të parën të pershkruar më lart, lakorja e kalibrimit të përgjigjes së biosensorit me inhibicion, gjatë përqëndrimeve në rritje të pesticidit, arrihet duke regjistruar përqindjen e inhibimit të përgjigjes së biosensorit, në funksion të përqendrimin të atrazinës në solucionin ku është zhytur biosensori për një kohë të caktuar (koha e inkubimit). Rezultati krahasohet me përgjigjen e biosensorit në mungesë të pesticidit fig. 2. Për lakoren e kalibrimit janë përdorur kalibrimet herë pas here me solucione standarti të atrazinës në kloroform të ngopur me ujë: $1,0 \times 10^{-7}$ mol $^{-1}$, $1,0 \times 10^{-6}$ mol $^{-1}$, $1,0 \times 10^{-5}$ mol $^{-1}$, $1,0 \times 10^{-4}$ mol $^{-1}$, $1,0 \times 10^{-3}$ mol $^{-1}$ e $1,0 \times 10^{-2}$ mol $^{-1}$. Në një gotë kimike të termostatuar permban 10 ml të solventit organik (kloroform të ngopur me uje) e nen veprimin e perzjeresit manjetik, zhytet biosensori pritet të stabilizohet sinjali, quindi shtohen 200 µl soluzion të fenolit $2,5 \times 10^{-2}$ mol $^{-1}$ në kloroform të ngopur me ujë, shënohet një ndryshim sinjali në nA. Boshatiset gota kimike dhe zbatohet nga e para procedura kryhet matja duke shtuar 10 ml tretës, më parë 200 µl të një solucioni të ndryshëm nga atrazina, pritet për një periudhë kohe, pra njëlloj me kohën e inkubimit (koha e kontaktit midis enzimës dhe inhibitorit, optimizimi i mëparshëm), shtohet 200 µl solucion i fenolit $2,5 \times 10^{-2}$ mol $^{-1}$ në kloroform. Mbas

shtimit të soluzionit fenolik si regjistrohet një ndryshim signali ne nA, che viene konfrontohet me atë të shenuar me pare.

Per ndertimin e lakores se kalibrimit ne abshise vihete perqendrimi final i atrazines dhe ne ordinate raporti:

$$\Delta i\% = \frac{[(Sc - Sd)]}{Sc} \times 100$$

Sc = ndryshimi i intensitetit të korrentit për shkak të shtimit të fenolit, në mungesë të pesticidit në solucionin.

Sd = ndryshimi i intensitetit të korrentit për shkak të shtimit të fenolit mbasi biosensori është inkubuar në prani të pesticidit.

Në figurë është treguar rruga e ndjekur nga sinjali në mungesë dhe në prani të inhibitorit [figura 2].

f). Optimizimi i kohes së inkubimit

Per të optimizuar kohën e inkubimit janë kryer një sasi matjesh duke aplikuar metoden e dytë e duke mbajtur kostante përqendrimin final qoftë të atrazines ($1,0 \times 10^{-3}$ mol $^{-1}$), qoftë atë të fenolit $2,5 \times 10^{-2}$ mol $^{-1}$, për “koha e inkubimit”, ne prani të pesticidit, ne rritje, respektivisht me (150; 300; 600; 900 e 1500 sekonda). Ne grafik vlerat e $\Delta i\%$, ne funksion të kohes se inkubimit, ndertohet lakorja ne funksion të kohes se inkubimit optimal.

g). Analiza e pesticideve triazinike

Me dy pesticidet e tjera triazinike që janë përdorur, përveç atrazinës, janë kryer eksperimente sipas procedurës së dytë të punës.

h). Matje të recuperimit mbi kampione reale

Janë kryer shumë prova laboratorike për të përcaktuar rikuperimin e pesticidit në kampione vegjetale natyrale. Përgatitet solucioni i atrazinës duke tretur 10,0 mg të pesticidit në 20 ml eter. Peshohen 10 g kampioni vegjetal bar fushe ose ullinj), përzihen me solucion eteri që përmban pesticid; pastaj eteri lihet i gjithi të avullojë. Kampioni vegjetal shpëlahet për tre herë me 6,5 ml kloroform të ngopur me ujë. Solucioni i larjes bashkohet dhe çohet në volum 20,0 ml dhe i përgatitur në këtë mënyrë përdoret për matje. Përgatitet dhe një solucion standart i atrazinës duke tretur 10,0 mg të pesticidit në 20,0 ml di

kloroformit të ngopur me ujë (solucion standart i riferimit). Në këtë mënyrë vazhdohet matja e pesticidit në kampionin e ujrave të larjes, duke përdorur metodën e parë. Rritet përqëndrimi i pesticidit në kampion për tu krahasuar me sinjalin e kapur. Në solucionin standart të riferimentit të pesticidit.

Në këtë mënyrë vazhdohet me matjet sipas metodës së dytë siç u përshkrua më parë duke u ngjitur në përqëndrimin e pesticidit në kampionin për analizë dhe duke e krahasuar atë me sinjalin direkt që arrihet nga solucionin i kloroformit dhe ujrave të larjes me atë të solucionit standart të riferimit. Më në fund, në të njëjtën mënyrë zbatohet metoda e dytë duke realizuar depozitimin e pesticidit mbi një kokër limoni me peshë 51 g, përdoret solucionin i eterit pesticid (10.0 mg në 20.0 ml eter), në të njëjtën mënyrë duke kryer eksperimentet e përshkruara më lart. Në këtë mënyrë arrihet një përqëndrim i pesticidit në kampion real 0,1% në peshë, përta i përket barit në fushën e ullinjve, ndërsa 0,02%, përta i përket agrumeve (limonit).

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Problemi kryesor për t'u zgjidhur në këtë rast ishte përdorimi i një metode për përcaktimin e pesticideve triazinike duke përdorur një biosensor me inhibicion, që vepron në tretës organik d.m.th një OPEE. Nga të dhënat e literaturës [16, 18] është vënë re që tretësit më të mirë janë: eteri, metanoli dhe kloroformi, duke përjashtuar, tretës shumë volatil, ose që demtojnë aktivitetin enzimatik, për shembull metanoli.

L'OPEE është e ndërtaur nga teflon dhe enzima është e imobilizuar në kappa-karraginin, një tip i imobilizimit që përshkruhet në shumë punime shkencore të tjera [19, 20], tregon rezultate pozitive kur punohet në solvent organik. Metoda është optimizuar nëpërmjet zbatimit të dy procedurave eksperimentale: metoda e parë bazohet në fazën organike me substraktin fenol ndërsa si inhibitor përdoret pesticidi. Në metodën e dytë ka dy përgjigje të biosensorit: njëra në mungesë dhe tjetra në prani të inhibitorit pas periudhës së inkubimit.




Figura 5: Atrazina: Lakorja e kalibrimit (Metoda 1)

$$y = (10,3 \pm 5,9) \text{Log}(x) + (71 \pm 32)$$

$$y = (13,1 \pm 5,4) \text{Log}(x) + (120 \pm 30)$$

$$r^2 = 0,9215 \quad (1 - \alpha) = 0,90 \quad t = 2,7764$$

$$x = \text{mmol/L} \quad y = \%I$$

intervali i linearitetit nga $4,0 \times 10^{-3}$ mmol/L në $2,3 \times 10^{-1}$ mmol/L "pooled SD" % = 13%




Figura 6: Atrazina: Lakorja e kalibrimit (Metoda 2)

$$r^2 = 0,9724 \quad (1 - \alpha) = 0,90 \quad t = 2,3646$$

$$x = \text{mmol/L} \quad y = \%I$$

Intervali i linearitetit nga $2,0 \times 10^{-3}$ mmol/L në $2,5 \times 10^{-1}$ mmol/L.

"pooled SD" % = 11 %




Figura 7: Atrazina desentil: Lakorja e kalibrimit (Metoda 2)

$$y = (4,8 \pm 2,0) \log(x) + (66 \pm 11)$$

$$r^2 = 0,9559 \quad (1 - \alpha) = 0,90 \quad t = 2,776$$

$$x = \text{mmol/L} \quad y = I \%$$

Përqendrimi i atarzinës	Kampioni 1 Bar i fushës	Kampioni 2 Bar i fushës	Kampioni 3 Ulli	Kampioni 4 Limon
Vlera e kërkuar (nominale)	0.10	0.05	0.10	0.02
Vlera eksperimentale	0.087 ± 0.003	0.042 ± 0.003	0.093 ± 0.002	0.018 ± 0.002
Rekuperimi	87%	84%	93%	90%

Tabela 1: Rekuperimi i pesticidit në kampion real vegjetal

Të dhënat e lakores së kalibrimit, kur esperimenti kryhet në dy perzierje të ndryshme tretësi janë prezantuar në grafikun (Figurat 5-7). Vihet re në të dyja rastet se në të dyja rastet grafiku logaritmik, tipik i përgjigjes të një biosensori me inibim [19], mund të jetë i linearizuar, duke vënë të dhënat në një diagrame gjysme logaritmike.

Në kompleks krahasimi i të dhënave eksperimentale të gjetura lejon marrjen e rezultateve të plota dhe lejon të themi që në praktikë veprohet pothuaj në të njëjtën mënyrë për dy tretësa të ndryshëm dhe në këtë rast intervali i linearitetit është pak më i gjerë, koeficienti i korelacionit pak më i mirë dhe një interval i konfidencës më i mirë se sa kur punohet me perzierjen kloroform-hekzan. Kështu që vlen të theksojmë që të gjitha analizat janë kryer në kloroform të ngopur me ujë.

Intervali i linearitetit nga $2,0 \times 10^{-6}$ mmol/L në $2,0 \times 10^{-1}$ mmol/L

Për të optimizuar metodën e parë të analizës janë realizuar shumë matje për të përcaktuar përqendrimin optimal të fenolit; ndërsa përqendrimi i substraktit optimizohet në metodën e parë të analizës. Analiza e lakores në fig. 3 lejon të themi se përgjigja më e lartë është arritur për një përqendrim të fenolit $2,5 \times 10^{-2}$ mol/L. Ky përqendrim është zgjedhur për tu zbatuar në të gjitha matjet.

PERFUNDIME

- Rezultatet e arritura tregojnë vlerën komplekse të kësaj metode. Biosensori në tirozinazë vepron në dy tretësa të ndryshëm: fazë organike dhe ujore si dhe lejon përcaktimin e dy analizëve të ndryshëm.
- Biosensori në tirozinazë në konfigurimin OPEE shërben për përcaktimin e pesticideve triazinike më mirë në tretës organik.
- Zvogëlohet rreziku i nënvleftësimit të përqendrimit të këtyre pesticideve për shkak të vështirësisë së tyre të tretjes në fazë ujore.

BIBLIOGRAFIA

1. L. Campanella, M.P. Sammartino, M. Tomassetti; Sensors and Actuators B, 7 (1992), pp 383-388.
2. L. Campanella, G. Favero, M.P. Sammartino, M. Tomassetti; Talanta, 41 (1994), pp 1015-1023.

3. L. Campanella, S. De Luca, M.P. Sammartino, M. Tomassetti; *Analytica Chimica Acta* , 385 (1999), pp 59-71.
4. L. Campanella, L. Persi, M.P. Sammartino, M. Tomassetti, S. Zanella; *Annali di Chimica*, 90 (2000), pp 35-49.
5. L. Campanella, E. Martini, D. Lelo, M. Tomassetti: "Organophosphorus and carbamate triazinic and benzotriazinik pesticide analysis using un inhibition tyrosinase organic phase enzyme sensor". *Journal of Analytica Chimica Acta*, 587 (2007), 22-32
6. L. Campanella, R. Dragone, D. Lelo, E. Martini, M. Tomassetti "Tyrosinase inhibition organic phase biosensor for triazinic and benzotriazinic pesticides analysis" *Journal of Analytical and Bioanalytical Chemistry*, 384 (2006): 915-921.

AVANTAZHET DHE KUFIZIMET E METODËS SË EKSTRAKTIMIT ME CO₂ NËNKRITIK NË KRAHASIM ME METODAT TRADICIONALE TË EKSTRAKTIMIT TË BIMËVE MEDICINALE DHE AROMATIKE

S. ABAZI, K. TARAJ

Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës, Bulevardi Zogu i Parë, Tiranë, ALBANIA

AKTET IV, 1: 48 - 54, 2011

PERMBLEDHJE

Analiza e përbërjes kimike të komponentëve volatilë të konopicës (*Vitex agnus-castus*) në ekstrakte të mara me metoda klasike, do të krahasohet me atë të ekstraktimit me CO₂ në gjendje nën kritike. Si metoda klasike janë përdorur ato të ekstraktimit me tretësa organikë, si hekzan dhe diklorometane (DCM), në refluz dhe në Soxhlet, si dhe distilimi me avuj uji. Përbajtja kimike e këtyre ekstrakteve është krahasuar me atë të ekstraktit të marë me CO₂ nën kritik. Ky ekstraktim është bërë në një autoklavë në temperaturë 35⁰C dhe 65bar që imiton parimin e aparatit Soxhlet. Në këto kushte CO₂ është akoma një lëng por shumë afër gjemdjës së tij kritike. Analiza kimike e përbërjes së ekstrakteve të marra është bërë me GC-M

Fjale kyce: bimë medicinale, CO₂ nënkritik, vajra esencial

SUMMARY

The analysis of extracts of konopica (*Vitex agnus-castus*) taken from classical methods of extraction will be compared to the extract taken from subcritical CO₂. As classical methods have been used those of solvent extraction, like hexane and dichloromethane (DCM), in reflux and under Soxhlet extraction, and also the distillation with water. Chemical composition of these extracts has been compared to the chemical composition of subcritical CO₂. This extraction has been done in autoclave under pressure, 65bars and in a temperature 35⁰C. In these conditions the CO₂ is still in liquid condition. This method is an imitation of the Soxhlet extraction. The chemical analyses have been done with a GC-MC.

HYRJE

Analiza e përbërjes kimike të bimëve medicinale me metoda standarte të ekstraktimit me tretësa organike dhe ujqorë është përshkruar shumë mirë në literaturë. Gjithashtu shpesh herë janë përdorur edhe metodat e ekstraktimit me lëngje në gjendje mbikritike kritike (super fluid extraction, SFE) [1]. Ne disa raste janë përdorur edhe gaze të lëngëzuar. Këtu ne do të paraqesim një metodë që paraqet ekstraktimin e konopicës me CO₂ nën kritik, por që ndodhet fare pranë gjendjes kritike.

Si bimë medicinale kemi zgjedhur konopicën (*Vitex agnus castus*) [2] pasi është një bimë

shumë e rëndësishme medicinale dhe në vendin tonë gjendet me shumicë. Kjo bimë për shkat të rëndësisë së saj në mjekësi ka qënë studiuar në imtësi. Në literaturë gjenden gjithashtu edhe raste të studimit të saj me lëngje mbikritikë [3]. Por gjatë përdorimit të lëngjeve mbikritike duhet shpesh të përdoren kushte presioni dhe të temperaturë shumë të larta, të cilat shkojnë shpesh herë deri në 400 bar dhe 200⁰C. Kurse në rastin tonë ne jemi pothuajse në temperaturë ambienti dhe në presion deri 65 bar. Qëllimi i këtij punimi është të krahasojmë përbërjen kimike të ekstrakteve të mara me metoda kalsike e atë të ekstraktimit me CO₂. Supozohet se CO₂ i

lëngët në gjendje nën kritike ka një polaritet të ulët. Për këtë qëllim janë përzgjedhur si tretës organikë hekzani dhe diklorometani. Nga natyra e komponimeve kimike që do të ekstrahohen do të mund të gjykohej mbi polaritetin relativ të CO₂ nënkritik.

MATERIALI DHE METODA

Bima e përzgjedhur për studim është konopica. Vendi i saktë i grumbullimit të saj nuk dihet, por në kemi marrë nga grumbullues të bimëve medicinale të rrethit të Fierit. Për ekstraktim u përdorën frutat e bimës, të cilat u grinë në formë pluhuri para se të përdreshin në ekstraktim.

Distilimi me ujë u bë në një balon 2L. 40g bimë e grirë u përziej me 1L ujë dhe u distiluan në një aparat Klevenger për 4 orë. Më pas fazat u ndanë dhe u logarit rendimenti në çdo rast. Analiza e cdo ekstrakti u bë me Gaskromatograf (GC) me detektor Masspektrometër (MS).

Ekstraktimi me solvent u bë në një aparat Soxhlet. Në gishtëz u futën 25g bimë e bluar dhe u bë ekstraktimi për 5 orë. Më pas solventi u largua dhe në rotaevaporator dhe mbetja u analizua me GC-MS. Si solventë u përdorën hekzani dhe diklorometani (DCM).


Kurse ekstraktimi me CO₂ u bë në një autoklavë si në Figurën 1

Presioni i përdorur është 65bar dhe temperatura 35°C. Ekstraktimi u bë për rreth 4 orë, që i përgjigjet 12 cikleve Soxhlet. Otpimizimi i kohës së ekstraktimit ishte bërë më parë. Vazhdimi i ekstraktimit për më tepër se 4 orë nuk sjell ndonjë rritje të ndjeshme të rendimentit të ekstraktimit. Pas përfundimit të ekstraktimit u largua CO₂ i lëngët dhe ekstrakti u mor i pastër, pa gjurmë solventi.

TLC u bënë me pllaka silice dhe si eluent u përdor një përzierje hekzan / acetat etili 5/1. Si detektor u përdor vanilina.

GC u bë në një aparat të tipit Varian, i pajisur me një kolonë ZB-5 30m të gjatë

dhe me një detektor mas-spektrometër. Programi i temperaturës: 1 minutë në 80°C, gradient temperature 5°C/min deri në 280°C.



1. Ftohës, 2. Manometër, 3. Dritare, 4. Ventil, 5. Guarnicion, 6. Cilindër, 7. Bazamenti, 8. Gëzhoja, 9. Gota me sifon, 10. Gota për mbledhjen e ekstraktit, A. Lëngu –gazi ekstraktues (dioksid karboni) B. Ekstrakti, C. Tretësira e ekstraktit, D. material për ekstraktim

Figura 1. Skema e aparatit për ekstraktimin me CO₂

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Distilimi me ujë i konopicës dha 0.17g ekstrakt për 40g bimë të përdorur, që i përgjigjet një rendimenti prej 0.42%. Ekstrakti i marrë u hollua me hekzan dhe u injektua në GC-MS. Kromatogrami i paraqitur në Figurën 2 tregon

përbërjen kimike të komponimeve volatilë të konopicës.

Në këtë kromatogramë do vihen re vetëm ato komponime volatilë të cilat kodistilojnë me ujin, prandaj dhe rendimenti është i ulët.

Ekstraktimi Soxhlet i konopicës me heksan dhe 2.28g ekstrakt për 25.83g bimë të përdorur, që i përgjigjet një ërendimenti prej 8.83%. Pas avullimit të heksanit në rotaevaporator mbetja u hollua me heksan dhe u injektua në GC-MC. Figura 3 tregon kromatogramën e marrë në këtë rast.




Figura 2. GC-MS i ekstraktit të distilimit me ujë të konopicës




Figura 3. Kromatograma e ekstraktit të marrë nga Soxhlet me heksan




Figura 4. Kromatograma e ekstraktit të marrë nga Soxhlet me DCM




Figura 5. Kromatogramat e distilimit me heksan dhe DCM

Duke e krahasuar me kromatogramën e marrë nga distilimi me ujë I konopicës hiet re se kemi një mori piqesh në zonën e temperaturave të larta.

Këto janë të gjitha ato substanca që ne nuk i shohim në distilimin me ujë pasi nuk kodistilojnë me ujin. Natyra e këtyre substancave është e

ndryshme dhe përfshin një serë komponimesh jo polarë por që kanë një pikë vlimi të lartë. Analiza me MS e tyre tregoi se ato janë në përgjithësi dyllra dhe disa komponime me baze steroidale. Kurse përsa i përket komponimeve volatile kemi një ngjashmëri të madhe me kromatogramën e distilimi me avuj uji.

Distilime me Soxhlet duke përdorur DCM si solvent dha 2.11g ekstrakt për 26.93g bimë të përdorur, që do të thotë një rendiment prej 7.84%. Vihet re se rendimenti me Soxhlet me DCM jep një rendiment pothuajse të njëjtë me atë me hekzan. Pas avullimit të solventit ekstrakti u realizua me GC-MS. Figura 4 paraqet kromatogramën e marë në këtë rast.

Krahasimi i kromatogramës me DCM me atë me hekzan tregon se kemi pothuaj të njëjtën përbërje kimike por raporti i disa substancave është i ndryshëm. Kjo spjegohet për shkakt të ndryshimeve në polaritet që kanë këto dy substanca. Vihet re se kromatograma e ekstraktit me DCM është më e ngarkuar me komponime me pike vlimi më të lartë se sa ajo me hekzan.

Figura 5 paraqet një krahasim të këtyre dy ekstrakteve. Ekstraktimi me CO₂ nënkritik dha një rendiment më të ulët se sa ekstraktimi me soxhlet por më të madh se sa ai i distilimit me

ujë. Nga ky ekstraktim u morën 0.31g ekstrakt për 30.1g bimë, që i përgjigjet një rendimenti prej 1.03%. pas largimit të CO₂ ekstrakti u mor në gjendje të pastër dhe pas hollimit me hexan u injektua në GC-MS. Figura 6 tregon kromatogramën e marë në këtë rast. Nga kjo kromatogramë vihet re se CO₂ ka një përbërje kimike më të larmishme se sa ekstraktet e hekzanit dhe DCM. Vihet re se komponimet volatile të kromatogramës janë në përqindje më të lartë të CO₂ se sa të hekzanit dhe DCM.

Në Figurën 7, janë paraqitur të treja kromatogramat së bashku dhe këtu vihen re disa ndryshime të ndjeshme në to. Nga kjo paraqitje vihet re se jo vetëm që komponimet volatile janë në përqindje më të lartë, por vihen re se ekstraktimi me CO₂ përmban edhe disa pike që nuk gjenden fare të rasti i i ekstraktimit me hekzan dhe me DCM. Kjo ndodh me piquet me RT=2.18, 12.96, 28.5 dhe 32.28. Gjithashtu vihet re edhe se piku me RT=12.12 gjendet në përqindje më të madhe të CO₂. Analiza MS e këtyre piqueve tregoi se komponimi me RT=2.18 është me dy cikle [2.2.1]heptan, 2,2dimetil,3metilen.





Figura 6. Kromatograma e ekstraktit të marrë me CO₂Figura 7. Kromatograma e ekstrakteve të marra me CO₂, heksan dhe DCM

Për shkak të pikës së ulët të vlimit që ka ky komponim, ka shumë mundësi që ai të avullojë gjatë eliminimit të solventit me avullim. Kurse në rastin e CO₂, solventi, pra CO₂ është një gas dhe largohet në temperaturë më të ulët se ajo e ambientit duke lënë pas gjithë komponimet volatile. Pra ekstraktimi me CO₂ ka një përparësi shumë të madhe në rastet e izolimit të komponimeve volatië të bimëve. Kurse komponimet me RT= 28.5 dhe RT=32.28 janë steroide, derivate të androstanit. Ko tregon se CO₂ është selektiv edhe për substanca të kësaj natyre.

Si konklusion mun të themi se rendimenti i ekstraktimit me CO₂, megjithëse është më i

vogël se sa ai i ekstraktimeve me solvent, është më i madh se sa ai i distilimit me avuj uj. Polariteti i CO₂ është më i ngjashëm me atë të heksanit. Ai ka përparësi ndaj ekstraktimeve me solventë organikë në rastet kur do të izohet substanca shumë volatile. Gjithashtu ky ekstraktim tregon një fare selektiviteti ndaj molekulave me natyre steroidale.

BIBLIOGRAFIA

1. Lentz H., (1988): "Vorrichtung zur Extraktion durch Flüssigkeiten unter hohen Dampfdrücken" German Patent, 88108074.....
2. www.vitex agnus-castus.com

3. Cossuta D., Simandi B., Hohmann J. (2008):
Supercritical fluid extraction of *Vitex agnus-
castus* fruit. *The Journal of Supercritical Fluids*
47: pp.188-194.

ANALIZA E PËRBËRJES KIMIKE TË EKSTRAKTEVE TË DISA BIMËVE MEDICINALE DHE AROMATIKE TË MARRA NGA EKSTRAKTIMI ME CO₂ NËNKRIK

S. ABAZI, K. TARAJ, H. FICO

Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës, Bulevardi Zogu i Parë, Tiranë, ALBANIA

AKTET IV, 1: 55 - 58, 2011

PERMBLEDHJE

Ekstraktimi i bimëve medicinale dhe aromatike me gaze në gjëndje kritike ose mbikritike është përdorur gjerësisht në laboratore dhe industri. Por duhet thënë se janë shumë të ralla rastet e përdorimit të këtyre gazeve si lëngje në gjëndje nënkritike. Pranë departamentit tonë ne kemi ndërtuar një aparat i cili lejon imitim e një aparati Soxhlet, por duke përdorur si tretës CO₂ të lëngshëm pranë gjëndjes kritike. Në këtë artikull ne do paraqesim një studim paraprak të ekstraktimit të disa bimëve aromatike dhe medicinale me CO₂ nënkritik si dhe analizën e përbërjes kimike të ekstrakteve të marra. Gjithashtu ne do të paraqesim dhe një studim mbi efektin e numrit të cikleve mbi rendimentin e ekstraktimit. Analiza e ekstrakteve krudo është bërë me GC. Identifikimi i përbërësve të secilit ekstrakt është bërë me mas spektrometër (GS-MS).

Fjale kyce: CO₂ nënkritik, GC-MS, vajra esencial, bimë medicinale

SUMMARY

The extraction of medicinal and aromatic plants with critical and supercritical gases has been used widely in laboratories and industry. But, there are rare cases of uses of subcritical gases for such purpose. In our Department we have build an apparatus which imitates the Soxhlet apparatus using subcritical CO₂ as solvent. In this work we will present the results of extraction of some medicinal and aromatic plants using subcritical CO₂, and the analysis of chemical composition of these extracts. Also some studies on the impact of the number of Soxhlet cycles on the yield of extraction will be presented. The extract analyses were done with GC and the identification of their components was done with GC-MS.


HYRJE

Përdorimi i lëngjeve në gjëndje mbikritike është studiuar në hollësi në shumë botime dhe libra [1, 2, 3]. Këto lëngje janë përdorur në shkallë industrial për ekstraktime të komponentëve organikë. Shembulli më tipik është ai i ekstraktimit të kafeinës nga kokrat e kafesë [4]. Gjithashtu këto teknika janë përdorur gjerësisht në ekstraktimin e bimëve medicinale dhe aromatike. Gjatë përdorimit të lëngjeve mbikritike përdoren shpesh kushte presioni dhe temperature shumë të larta, të cilat shkojnë shpesh herë deri në 400 bar dhe 200°C, gjë e cila rit koston e impianteve dhe shton rezikshmërinë e punimit me to.

Kurse në këtë punim ne do të paraqesim një alternative tjetër për ekstraktimin e bimëve aromatike dhe medicinale e cila përdor CO₂ në gjëndje nënkritike. Kjo lejon kushte pune më të moderuara, temperaturë reth 35°C dhe presione nën 65bar. Në këto kushte ne mund të realizojmë kushte të ngjashme me ato të aparatit Soxhlet pasi CO₂ është gjithmon si një lëng që mund të vlojë dhe të kondensohet duke realizuar ciklin e Soxhlet.

Për të studiuar këtë metodë ne kemi zgjedhur ekstraktimin e dy bimëve medicinal: lules së basanit (*hypericum perforatum*) dhe të konopicës (*Vitex agnus-castus*). Ekstraktet e mara janë analizuar për përbërjen e tyre kimike me GC-MS.

Si qëllim i këtij studimi ka qënë gjithashtu edhe studimi i kinetikës së ekstraktimit. Për këtë qëllim ekstraktimet u bënë me numer ciklesh në ritje dhe u vëzhgua impakti i kohëzgjatjes së ekstraktimit në rendimentin e ekstraktimit.



1. Ftohës, 2. Manometër, 3. Dritare, 4. Ventil, 5. Guarnicion, 6. Cilindër, 7. Bazamenti, 8. Gëzhoja, 9. Gota me sifon, 10. Gota për mbledhjen e ekstraktit, A. Lëngu –gazi ekstraktues (dioksid karboni) B. Ekstrakti, C. Tretësira e ekstraktit, D. materialin për ekstraktim

Figura 1. Skema e aparatit për ekstraktimin me CO₂

MATERIALI DHE METODA

Bimët e zgjedhura, lule basani (*Hypericum perforatum*) dhe konopica (*Vitex agnus-castus*), janë tharë në një furë në 30°C me ajër të ngrohtë deri në peshë konstante dhe më pas janë bluar imët. Më pas janë sigur në një sitë me diametër 560µm dhe pas peshimit të sasisë së duhur janë ekstraktuar me CO₂ pranë gjendjes kritike, 35°C

dhe 65 bar. Në këto kushte koha e kryerjes së një cikli është rreth 15 minuta. Në rastin e konopicës u përdorën frutat e bimës kurse në rastin e lules së basanit u përdor e gjithë bima. Pas ekstraktimit prej rreth 4 orësh, CO₂ i lëngët është avulluar dhe ekstrakti krudo është përfituar i pastër nga gjurmë solventësh organikë. Ekstraktimi me CO₂ u bë në një autoklavë si në Figurën 1.

Optimizimi i kohës së ekstraktimit u bë duke ekstraktuar bimën për 1, 3, 6 dhe 48 cikle. Vazhdimi i ekstraktimit për më tepër se 4 orë nuk sjell ndonjë rritje të ndjeshme të rendimentit të ekstraktimit.

Analiza e ekstraktit total u bë me TLC dhe me GC-MS. TLC u bënë me pllaka silici dhe si eluent u përdor një përzierje hekzan / acetat etili 5/1. Si detektor u përdor vanilina. GC u bë në një aparat të tipit Varian, i pajisur me një kolonë ZB-5 30 m të gjatë dhe me një detektor mas-spektrometër. Programi i temperaturës: 1 minutë në 80°C, gradient temperature 5°C/min deri në 280°C.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Ekstraktimi i 11.5 g lule basani dha 0.33 g ekstrakt, që i përgjigjet një rendimenti prej 2.87%, pas 12 ciklesh ekstraktimi. Ekstrakti i marrë, pas largimit të CO₂, u hollua me hekzan dhe u injektua në GC-MS. Kromatogrami i paraqitur në Figurën 2 tregon përbërjen kimike të komponimeve volatilë të lules së basanit.

Ekstraktimi i 20.02 g konopice dha 0.39 g ekstrakt që i korrespondon një rendimenti prej 1.9%. Numri i cikleve Soxhlet ishte 12 dhe ekstraktimi vazhdoi për 4 orë. Ekstrakti i marrë, pas largimit të CO₂, u hollua me hekzan dhe u injektua në GC-MS. Kromatogrami i paraqitur në Figurën 3 tregon përbërjen kimike të komponimeve volatilë të konopicës.

Koha e ekstraktimit prej 4 orësh u gjet pasi u kryen një sërë eksperimentesh me numër ciklesh të ndryshme. Tabela 1 paraqet rezultatet e marra për rendimentin e ekstraktimit të lules së basanit në varësi të numrit të cikleve të ekstraktimit.




Figura 2. GC-MS i ekstraktit të lules së basanit




Figura 3. Kromatograma e ekstraktit të konopicës

Po e njëjta gjë u bë edhe me konopicën. Tabela 2 paraqet rezultatet e marra për rendimentin e ekstraktimit të konopicës në varësi të numrit të cikleve të ekstraktimit.

Nga krahasimi i të dhënave të tabelave të mësipërme mund të themi se shpejtësia e

ekstraktimit dhe rendimentet e ekstraktimit në rastin e lules së basanit janë më të larta se në rastin e konopicës. Kjo mund të shpjegohet me faktin se në rastin e konopicës ne po ekstraktojmë frutin e saj kurse në rastin e lules së basanit kemi bimën e tërë.

Nr. i cikleve	1 (27 min)	3 (49 min)	6 (95 min)	48 (12 orë)
Sasia e bimës	11.71 g	12.18 g	11.2 g	11.5 g
Sasia e ekstraktit	0.12 g	0.16g	0.28g	0.33g
Rendimenti %	1.02	1.31	2.5	2.87

Tabela 1. Varësia e rendimentit të ekstraktimit të lules së basanit nga numri i cikleve

Nr. i cikleve	1 (21 min)	3 (41 min)	6 (82 min)	48 (12 orë)
Sasia e bimës	20 g	20 g	20 g	20 g
Sasia e ekstraktit	0.05 g	0.18 g	0.35 g	0.39 g
Rendimenti %	0.24	0.91	1.78	1.99

Tabela 2. Varësia e rendimentit të ekstraktimit të konopicës nga numri i cikleve

Gjithashtu vihet re se vazhdimi i ekstraktimit për më tepër se 4 orë (12 cikle) nuk do të sillte

ndonjë rritje të ndjeshme të rendimentit. Pas 4 orësh ne kemi marrë pothuaj 95% të rendimentit të masës së ekstraktueshme.

Si konkluzion mund të themi se kjo metodë mund të përdoret me sukses për ekstraktimin e bimëve medicinale. Ajo lejon kushte pune më të moderuara se sa lëngjet mbikritike dhe na jep ekstrakte bimore pa gjurmë solventësh organikë

BIBLIOGRAFIA

1. E.D. Ramsey, 1998: Analytical Supercritical Fluid Extraction, *Techniques*, Kluwer Academic Publisher
2. Jose L. Martinez, 2007: Supercritical Fluid Extraction of Nutraceuticals and Bioactive Compounds, Taylor & Francis Group
3. Larry T. Taylor, 1996: Supercritical Fluid Extraction, John Wiley&Sons, Inc.
- 4 Caffeine recovery from supercritical carbon dioxide, United States Patent 4996317

EVALUATION OF CHEMICAL-TECHNOLOGICAL INDICES IN SOME LINES AND CULTIVARS OF SOFT AND DURUM WHEAT VLERËSIMI I INDEKSEVE KIMIKË E TEKNOLOGJIKË NË DISA LINJA E KULTIVARË TË GRURIT TË BUTË E TË FORTË

VALENTINA ARAPI^a, VLADIMIR BANO^b

^aUniversiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Kamëz, Tiranë, Shqipëri

^bUniversiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Kamëz, Tiranë, Shqipëri

E-mail: valiarapi@albaniaonline.net

AKTET IV, 1: 59-63, 2011

PËRMBLEDHJE

Në 15 kultivarë dhe linja të grurit të butë e të fortë të mbjella në parcelat eksperimentale të rrethit të Lushnjës në vitet 2008-2009, janë vlerësuar indekset kimike e teknologjike, me qëllim përzgjedhjeje për cilësi. Ndërmjet përmbajtjes së proteinave dhe glutenit, në 9 e 6 kultivarët dhe linjat e marra në studim, rezultojnë me lidhje të tipit shumë të mirë ($r=0.79$, 0.77). Ndërsa, në linjat e grurit të fortë, vihen re lidhje shumë të forta e të mira ndërmjet përmbajtjes së volumit të bukës e glutenit ($r=0.92$), indeksit të glutenit ($r=0.62$), indeksit të glutenit e koeficientit të sedimentimit ($r=0.53$). Në treguesit teknologjikë, vlerat e vëllimit të bukës, numrit amilografik luhaten brenda standarteve të caktuara. Në bazë të rezultateve të treguesve kimikë dhe atyre teknologjikë, në linjat e marra në studim, vlerësojmë si më të mirat për t'u përfshirë në strukturën varietore, një linjë të grurit të butë si dhe tre linja të grurit të fortë.

Fjalë kyçe: Kultivarë, linja të grurit të fortë e të butë, tregues kimikë e teknologjikë.

SUMMARY

In the 15 cultivars of soft and durum wheat sown in the experimental plot of the district of Lushnja during the years 2008-2009, the chemical-technological indices were attentively evaluated for qualitative selective purposes. A medium strength relationship between the content of protein and gluten in the lines and cultivars of both soft and durum wheat was observed. However, there is a very strong correlation ($r = 0.86$) between the content of protein and the sedimentation coefficient (K-SDS), between the index of gluten and gluten ($r = 0.88$), and the index of gluten and the sedimentation coefficient ($r = 0.85$). Among the technological indicators, the values of bread volume, falling number, and pharino-graph fluctuates within the determined standards. Based on the attained results of the chemical-technological indicators in the studied lines and cultivars, one line of soft wheat and three lines of durum wheat have been selected for inclusion in the variety structure.

Key words: Cultivars, soft and durum wheat, chemical-technological indicators.

HYRJE

Thellimi i njohurive për krijimin e linjave dhe kultivarëve të grurit të butë e të fortë me tregues të lartë cilësorë, krahas atyre të prodhimit është në qendër të vëmendjes të institucioneve kërkimore-shkencore. Vlerësimet cilësore të grurërave përbëjnë një kontribut me vlerë për

prodhimin e bukës së grurit me cilësi të lartë (3, 8, 11).

Në këtë kuadër, vlerësimi i disa linjave e kultivarëve të grurit të butë e të fortë në bazë të treguesve kimikë e teknologjikë, përbën qëllimin e këtij studimi.

MATERIALI DHE METODA

Objekt i këtij studimi janë 15 kultivarë e linja të grurit të butë e të fortë, të mbjella në parcelat eksperimentale të rrethit të Lushnjës, në vitet 2008-2009, të analizuar për treguesit kimikë e teknologjikë, si vijon:

- Përmbajtja e proteinave të përgjithëshme sipas metodës së Kjeldahli-it (Nx5.7) (4).
- Përmbajtja e glutenit të njomë (4).
- Indeksi i glutenit u realizua me sistemin “ Glutomat Operating Manual “
- K-SDS sipas Axford dhe Dick J.Ë dhe J.S.Quick (1,3).
- Lënda minerale (4).
- Përmbajtja e lagështirës me metodën e tharjes në thermostat në temperaturë 105 -110 °C deri në peshë konstante (4).
- Falling Number (me Falling Number instrument)
- Vëllimi i bukës (sipas instruksionit të Aparatit Lab).

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Varietetet e ndryshme të grurit ndryshojnë në mënyrë të dukshme në përbërje. Ndryshimi më i rëndësishëm paraqitet në sasinë dhe cilësinë e proteinave. Mjaft e rëndësishme në vlerësimin cilësor të grurëve të butë e të fortë me qëllim përzgjedhjeje për cilësi buke, është përcaktimi i përmbajtjes së proteinave, glutenit të njomë, K-SDS, krahas treguesve të tjerë si: farinograma, ekstensograma, Falling Number etj (3, 6, 10, 11). Disa të dhëna të treguesve kimiko-teknologjikë jepen në Pasqyrën Nr 1. Përmbajtja e proteinave në 9 linjat e kultivarët e grurit të butë, luhatet mesatarisht nga 11.26-14.70% (kultivarët 3, 4) me një mesatare prej 13.29%, pra në vlera të larta, ndërsa në 6 linjat e kultivarët e grurit të fortë, luhatet mesatarisht nga 13.02-15.80% (linjat 6, 3) me një mesatare prej 14.35%, pra në vlera të larta.

Një tregues i rëndësishëm i aftësisë bukëpjekëse të një lloji të caktuar gruri është përmbajtja e glutenit. Duke vlerësuar sasinë dhe cilësinë e tij mund të nxirren të dhëna paraprake për cilësinë e bukës të një lloji të caktuar gruri (5,8,10,12). Vlerat mesatare të përmbajtjes së glutenit në 9

linjat e kultivarët e grurit të butë luhaten nga 21.20-29.00% (kultivarët 3, 2), pra nga vlera të ulëta deri të larta dhe një vlerë mesatare 24.46%, që i përgjigjet vlerave minimale të përmbajtjes së glutenit (12). Dallon për vlera të larta të këtij treguesi kultivari 2 me 29% gluten. Ndërmjet përmbajtjes së proteinave dhe glutenit rezulton një lidhje positive e tipit shumë të mirë ($r = 0.79$). Vlerat mesatare të raportit gluten / proteinë luhaten nga 1.67-1.97 (kultivarët 4, 1, 2). Në 6 linjat e kultivarët e grurit të fortë përmbajtja mesatare e glutenit luhatët nga 21.90-28.50% (linjat 6,5), pra nga vlera të ulëta deri të larta dhe një vlerë mesatare 26.05%, që i përgjigjet kufirit të vlerave mesatare të përmbajtjes së këtij treguesi. Linjat 5 dhe 4 dallojnë për vlera të larta të përmbajtjes së glutenit (28.50% dhe 28%). Një lidhje positive e tipit shumë të mirë ($r = 0.77$), rezulton gjithashtu midis përmbajtjes së proteinave dhe glutenit të njomë, ndërsa vlerat e raportit gluten/proteinë luhaten nga 1.68-1.97 (linjat 5, 6).

Lënda minerale në 9+6 linjat e kultivarët e grurit të butë e të fortë luhatet nga 1.02-1.62% (kultivari 3, linja 8) dhe nga 1.02-1.64% (linja 6, kultivari 2) me një vlerë mesatare 1.24%, që i përgjigjet vlerave normale të përmbajtjes së këtij treguesi (9).

Koeficienti i sedimentimit-SDS, sikurse gluteni, vlerëson cilësinë e proteinave të grurit. Vlera e testit të sedimentimit varet nga sasia dhe cilësia e glutenit. Gjithashtu, sa më e lartë të jetë përmbajtja e proteinave aq më e lartë është vlera e K-SDS. Krahas provës alveografike, farinografike, ekstësografike e tjerë, K-SDS është ndër treguesit indirekt të cilësisë bukëpjekëse të miellit të grurit (1, 7, 10). Në 9 linjat e kultivarët e grurit të butë, vlerat e K-SDS luhaten nga 43.20-70.70 ml (kultivarët 1, 2), pra nga vlera mesatare deri të larta me një mesatare 56.60 ml, që i përgjigjet vlerave të mira të përmbajtjes së këtij treguesi (1, 7). Ndërsa, raporti K-SDS /proteinë (vëllimi specifik i sedimentit), si shprehje e cilësisë së këtij treguesi për njësi proteinore luhatet nga 3.27-4.85 (kultivarët 1, 4) me një mesatare 4.34, vlera jo optimale në krahasim me vlerën 6.35 që rezulton për grurëra me cilësi të

mirë të proteinave në kokërr për bukë (7,10). Ndërmjet përmbajtjes së proteinave e K-SDS rezulton një lidhje e mirë ($r= 0.63$), ndërsa ndërmjet glutenit dhe K-SDS një lidhje e dobët. Në 6 linjat e kultivarët e grurit të fortë, vlerat e K-SDS luhaten nga 27.80-67 ml (kultivari 1, linja 4), pra nga vlera mesatare deri të larta me një

mesatare 47.93 ml, që i përgjigjet vlerave të mira të këtij treguesi. Ndërsa vëllimi specifik i sedimentit luhetet në vlera relativisht të ulëta (2.04-4.72) dhe një mesatare 3.30. Gjithashtu, vërehen lidhje pozitive të tipit të mirë ndërmjet proteinave, glutenit dhe K-SDS përkatësisht me $r = 0.52$ dhe $r = 0.61$.

No.	Mostrat e Grurit	Lag. %	Prot. %	Glu. e njome %	K-SDS ml	Glute n / Prot.	K-SDS / Prot.	Vëllim buke cm ³ / 100 gr. miell	Vëllim buke / gluten	Hiri %	F. N sec	Index Glu.
I Grurë i butë												
1	Dajti	13.40	13.20	26.10	43.20	1.97	3.27	390	14.94	1.34	440	38.30
2	David x Mec	13.90	14.70	29.00	70.70	1.97	4.81	393	13.55	1.07	485	30.00
3	Progres	13.00	11.26	21.20	51.70	1.88	4.59	380	17.92	1.02		40.10
4	LVS	13.10	13.80	23.00	67.00	1.67	4.85	414	18.00	1.24	400	89.35
5	Rowena x Mec x Abadanca x Rural	13.50	12.20	22.40	58.50	1.84	4.79	375	16.74	1.27	511	37.93
6	Virginia x Farneze x Mec x Dajti	12.70	14.10	24.50	63.60	1.74	4.51	404	16.49	1.26	461	48.48
7	E Techo x Agimi	12.80	14.12	25.00	61.90	1.77	4.38	440	17.60	1.25	247	54.40
8	Cenero x David x Mec	13.50	13.80	26.00	55.10	1.88	3.99	419	16.12	1.62	400	58.91
9	Ciano x Jubileo x Rexhina x L7 -76	13.10	12.50	23.00	48.30	1.84	3.86	427	18.56	1.08	360	66.81
II Grurë i fortë												
1	6/1	13.30	13.60	25.50	27.80	1.87	2.04	385	15.10	1.39	442	41.90
2	Creso	12.60	14.03	25.40	44.90	1.81	3.20	374	14.72	1.64	497	51.97
3	Emu "S" x Mexi "S" x Dajti	12.70	15.80	27.00	55.10	1.71	3.49	394	14.60	1.03	519	42.10
4	Fillo "S" x Dajti	13.70	14.20	28.00	67.00	1.97	4.72	400	14.28	1.26	529	66.62
5	Emu "S" x Mexi "S"	12.90	15.50	28.50	50.00	1.80	3.22	390	13.69	1.11	475	82.28
6	Ajacja x CD 58238 x Emu "S"	13.20	13.02	21.90	39.80	1.68	3.06	360	16.44	1.02	580	47.03

Tabela 1. Vlerat mesatare të disa treguesve kimiko-teknologjikë në disa linja e kultivarë të grurit të butë e të fortë.

Treguesit e vëllimit të bukës paraqesin etapën përfundimtare të vlerësimit cilësor të linjave dhe kultivarëve të grurit për bukë (2, 6, 10). Në 9 linjat e kultivarët e grurit të butë, volumi i bukës luhatët nga 375-440 cm³/100gr miell (linjat 5, 7) dhe një mesatare 404 cm³/100gr miell që i përgjigjet vlerave mesatare të këtij treguesi (8, 10, 11). Raporti vëllim buke/gluten luhatet në vlera të ulëta nga 13.55-18.56 (kultivari 2, linja 9). Ndërsa indeksi i glutenit luhatet nga 30-89.33% (kultivarët 2, 4), pra nga vlera mesatare deri të larta, që i përgjigjet cilësisë mesatare deri të lartë të miellit për bukë (3, 10). Dallojnë për vlera të larta të indeksit të glutenit, mbi 60%, kultivari 4 e linja 9 (89.33%, 66.81%). Vihen re një lidhje e tipit të mesëm ndërmjet volumit të bukës dhe proteinës ($r = 0.46$) dhe lidhje të dobëta ndërmjet glutenit të njomë, K-SDS dhe volumit të bukës.

Ndërsa vërehet një lidhje e mirë ndërmjet volumit të bukës dhe indeksit të glutenit ($r = 0.63$). Vihen re gjithashtu, lidhje të dobta ndërmjet treguesve të proteinave, glutenit, K-SDS dhe indeksit të glutenit. Në 6 linjat e kultivarët e grurit të fortë, volumi i bukës luhatet nga 360 - 400 cm³/100gr miell (linjat 6, 4) me një mesatare 383 cm³/100gr miell që i përgjigjet vlerave mesatare të këtij treguesi. Indeksi i glutenit luhatet nga 41.90-82.28% (kultivari 1, linja 5), pra nga vlera mesatare deri të larta. Dallojnë për vlera të larta të indeksit të glutenit linjat 5, 4 (82.28%, 66.62%). Ndërmjet proteinës, K-SDS dhe volumit të bukës rezultojnë lidhje të mira me $r = 0.67$ dhe $r = 0.60$, ndërsa vërehet një lidhje e tipit shumë të fortë ndërmjet volumit të bukës dhe glutenit ($r = 0.92$). Gjithashtu, ndërmjet glutenit, K-SDS dhe indeksit të glutenit rezultojnë lidhje të

mira ($r = 0.62$, $r = 0.53$), përkundrazi ndërmjet vëllimit të bukës, proteinës dhe indeksit të glutenit vërehen lidhje të dobta.

Në linjat dhe kultivarët e grurit të butë e të fortë të marra në studim, rezultojnë vlera të larta të Falling Number (F.N), që luhaten mesatarisht 415 sekonda (sec.) në 9 linjat e kultivarët e grurit të butë dhe 507 sec. në 6 linjat e kultivarët e grurit të fortë (Pasqyra 1). Në përgjithësi vlera e F.N mbi 300 sek. tregon aktivitet enzimatik minimal dhe grurë të shëndetshëm e cilësorë, ndërsa për vlera nën 250 sek. tregon aktivitet enzimatik të lartë dhe grurë të mbirë e të dëmtuar. Miellrat me vlera të F.N përtej vlerave të standarteve të caktuara, përmirësohen duke u përzier me nivele të caktuara të F.N me qëllim që mielli i përfutur të arrijë nivelin optimal të fermentimit të brumit të bukës (10, 11).

PË RFUNDIME

Nga studimi i indekseve kimiko-teknologjike në 15 mostrat e studjuara kemi arritur në përfundimet e mëposhtëme:

- Përbajtja e proteinave në 9+6 linjat dhe kultivarët e grurit të butë e të fortë luhatet mesatarisht nga 11,26-14.70% (kultivarët 3, 2) dhe 13.02-15.80% (linjat 6, 3), pra në vlera mesatare deri të larta e në vlera të larta.

- Përbajtja e glutenit në 9+6 linjat e kultivarët e grurit të butë e të fortë, luhatet mesatarisht nga 21.20-22% (kultivarët 3, 2) dhe nga 21.90-28.50% (linjat 6, 5), pra në vlera të ulëta deri të larta.

- Në 9+6 linjat dhe kultivarët e grurit të butë e të fortë, vlerat e koeficientit të sedimentimit luhaten mesatarisht nga të mira deri të larta dhe nga mesatare deri të larta (43.20-70.70 ml dhe 27.80-67 ml).

- Në 9+6 linjat dhe kultivarët e grurit të butë e të fortë, vëllimi specifik i sedimentit, si shprehje e cilësisë së këtij treguesi për njësi proteine, rezulton në vlera jo optimale (nën 6.35).

- Vëllimi i bukës në 9+6 linjat dhe kultivarët e grurit të butë e të fortë rezulton në vlera mesatare.

- Në 9+6 linjat dhe kultivarët e grurit të butë e të fortë rezulton një lidhje pozitive e tipit shumë të

mirë ndërmjet përbajtjes së proteinave dhe glutenit të njomë ($r = 0.79$ dhe $r = 0.77$).

- Në 9 linjat dhe kultivarët e grurit të butë vërehet një lidhje e tipit të mirë ndërmjet vëllimit të bukës dhe indeksit të glutenit ($r = 0.63$).

- Në 6 linjat e kultivarët e grurit të fortë vërehet një lidhje e tipit shumë të fortë ndërmjet volumit të bukës dhe glutenit ($r = 0.92$) dhe lidhje të mira ndërmjet glutenit, K – SDS dhe indeksit të glutenit ($r = 0.62$ dhe $r = 0.53$).

- 9+6 linjat dhe kultivarët e grurit të butë e të fortë karakterizohen nga vlera të larta të Falling Number (mbi 300 sek).

REKOMANDIME

Në bazë të rezultateve të arritura nga vlerësimi i indekseve kimikë e teknologjikë në 9+6 linja dhe kultivarë të grurit të butë e të fortë, vlerësojmë si më të mirat për t'u përfshirë apo ruajtur në strukturën varietore, kultivarin 2 të grurit të butë dhe linjat 3, 4, 5 të grurit të fortë.

BIBLIOGRAFIA

1. Axford D., WEE.Dermond and D.G. Redman (1979) "Note on the sodium dodecylsulphat test of bread making quality" *Cereal Chem.* Vol 56, p 582.
2. Boggini G., Tusa P., Pogna N.E. (1995) "Bread-making quality of durum wheat genotypes with some novel glutenin composition". *J. Cereal Sci.* 9: 131-138.
3. Dick J.W., Quick J.S. (1983) *Cereal Chem* 60; 315-318.
4. Frashëri M., Bimbashi H., "Analizat e produkteve ushqimore".
5. Johansson E., Nilson H., Mazhar H., Skerit I., Macritchie F., Svensson G. (2002) "Seasonal effects on storage proteins and gluten strength in flour Swedish wheat cultivars" *Jsci.Food agr.* 82: 1305-1311.
6. Kuktaite R., Johansson E., Juodeikiene G. (2000). "Composition and concentration of proteins in Lithuanian wheat cultivars; relationship with bread-making quality. *Cereal res. Comm.* 288: 195-202.
7. Preston K.R., P.R. March and K.H. Tipples (1982) "An assessment of the SDS sedimentation

for the production of Canadian bread wheat quality". *Canadian Journal of Plant Science*, Vol 62, Nr.3, pp 545-553.

8. Pasqualone A., Caponio F., Summo C., Arapi V. (2004) "Characterization of traditional Albanian breads derived from different cereals", *European Food Research and Technology*. Vol. 219, Nr 1, June 2004.

9. Përmeti M. (2002) "Biologjia e grurit".

10. Shellenberger I.A., B.L., D'Apollonia and K.A. Gilles, Elisabeth M., Osman, Y. Pomeranz, Gerland Reed "Wheat chemistry and technology" (Monograph series) pp. 3-19, 230-250.

11. Shuey W.C., Tipples K.H. (1985) *The Amylograph Handbook. Pellet Snack Food Technology*. Brochure Pavan.

12. Weegels P.L., Hammer R.I. and Schofield I.D. (1996) "Critical review, functional properties of wheat glutenin." *J.Cereal Sci* 23:1-18.

FREQUENCY OF THE SUBACUTE RUMEN ACIDOSIS (SARA) IN SOME CATTLE FARMS SHPESHTËSIA E ACIDOZËS NËNAKUTE TË RUMENIT (SARA) NË DISA FERMA LOPËSH

VANGJEL CERONI^a, EMILIAN SHABANI^b

^aDepartamenti i lëndëve klinike në Fakultetin e mjekësisë veterinarë, Tiranë, Shqipëri

^bMjek veteriner, Tiranë

Email: vangjelceroni@yahoo.com

AKTET IV, 1: 64-68, 2011

PËRMBLEDHJE

Studimi u realizua për të vlerësuar shpeshtësinë e acidozës nënakute të rumenit (SARA) në lopë dhe ndikimin në temperaturën trupore, në dendurinë dhe cilësinë e lëvizjeve peristaltike të rumenit, në strukturën e feceve dhe në pH e urinës. Nga Shtatori deri në Dhjetor 2009, përzgjedhëm 5 ferma lopësh dhe shfrytëzuam 113 mostra nga përmbajtja e rumenit të cilat u morrën nëpërmjet sondës nazo-ezafagale. Në çdo fermë kampionuam në mënyrë rastësore 2 grupe lopësh me nga 12 krerë, në fillim dhe në mes të laktacionit. Eksperimenti u krye në kushtet e të ushqyerit me racione të njëjta ushqimore. pH e përmbajtjes së rumenit e matëm me pH matës. Konsideruam të prekura nga SARA lopët të cilat kishin pH e përmbajtjes së rumenit 5.5 e më pak. Nga totali i krerëve të eksperimentuar gjetëm 26 lopë (21.6%) me SARA. Nga këto, 15 krerë (25%) ishin në fillimin e laktacionit dhe 9 krerë (15%) ishin në mesin e laktacionit. Në kufirin e acidozës (pH 5.6 deri 5.8) gjetëm 11 krerë (9.1%), nga të cilat 6 krerë (10%) në fillimin e laktacionit dhe 3 krerë (5%) në mesin e tij. Nuk gjetëm dukuri të ndikimit të SARA në temperaturën e trupit. SARA ndikon në numrin, fortësinë e lëvizjeve peristaltike të rumenit dhe në strukturën e feceve. pH i urinës nuk ka vlera diagnostikuese për identifikimin e SARA në lopë në të dy fazat e laktacionit. Cilësia e lëvizjeve peristaltike të rumenit dhe struktura e feceve mundet të shfrytëzohen në funksion të diagnostikimit të hershëm për SARA në lopë.

Fjalë kyçe: SARA, shpeshtësi, pH, rumen, fece.

SUMMARY

The study was conducted to assess the frequency of the SARA in the cows and its impact on body temperature, in the quality of the rumen peristaltic movements, in the structure of feces and urine pH. From September to December 2009, 5 cow farms were chosen and 113 samples taken by the naso-esophageal pump from the content of rumen were used. In every farm we randomly selected two groups with 12 heads of cows, at the start of lactation and in the middle of lactation. The experiment was conducted in terms of feeding the same rations. The pH of rumen content was measured with pH meter. Were considered affected by the SARA cows which had pH content of 5.5 rumen less. Of the total experiment heads were found 26 cows with the SARA. Of these, 15 heads were at the start of lactation and 9 heads were in the middle of lactation. In the limit of acidosis (pH 5.6 to 8.5) were found 11 heads, of which 6 heads at the start of lactation and 3 heads in the middle of lactation. We found no significant difference between SARA and the impact on body temperature. SARA affects the number and strength of rumen peristaltic movements and the structure of feces. Urine pH does not diagnostic value for identifying the SARA in cows in both stages of lactation. Quality of rumen peristaltic movements and fecal structure can be used in place of early diagnosis of SARA in cows.

Key words: SARA, frequency, pH, rumen, feces.

Acidoza nënakute e rumenit (SARA) është nga problemet më të rëndësishme ekonomike në fermat e lopëve për prodhim qumështi dhe karakterizohet nga episode ditore të uljes së pH ruminal midis vlerave 5.5-5 (Krause K.M. dhe Oetzel G.R., 2006) të shoqëruar me çrregullime të lëvizjeve peristaltike të rumenit. Këto çrregullime në lopët me gjendje SARA dhe pH të ulët të përmbajtjes shkaktohen nga grumbullimi i vetëm e lokal i acideve yndyrorë volative si pasojë e të ushqyerit të kafshëve, të cilat janë adaptuar të tresin foragjere me sasira jo të larta drithrash dhe jo nga grumbullimi i acidit laktik (Krause K.M. dhe Oetzel G.R., 2006). Shenjat e varfra klinike e bëjnë këtë patologji jo lehtësisht të dallueshme. Ato përfshijnë: uljen e konsumit të sasisë së ushqimeve të thata, laminitin, rumenitin, absceset e mëlçisë, embolinë bakteriale

pulmonare, humbje të peshës trupore dhe ulje të përqindjes së yndyrës në qumësht (Garret E.F., e bp. 1999; Kleen J.L. e bp. 2003). Rekomandimet e protokolluara për diagnozën e SARA, paraqesin kampionimin dhe kontrollin e lëngut të përmbajtjes ruminale nga përfaqësues të tufës të përzgjedhur rastësisht, nëpërmjet sondës nazoezofagale ose ruminocentezis (Enemark J. e bp., 2002). Nëse pas analizimit rezultojnë më shumë se 30% të krerëve me pH ruminal 5.5 ose më pak, atëherë grupi konsiderohet i prekur nga SARA (Nordlund K.V. e bp. 1995; Garret E.F. e bp. 1999). Në lopët e fermave në vendin tonë kanë filluar të dalin në pah pasojat e pranisë së SARA. Studimi synon sqarimin e shpeshtësisë së sindromit ose gjendjes SARA dhe kontribuon në vlerësimin e metodave të hershme diagnostike.

Ferma-madhësia e tufës (në krerë)	Grupi i lopëve	Numri i lopëve të kampionuara	Numri i lopëve me gjendje SARA	Në %
A- 139	Laktacion i hershëm	12	1	8.3
	Mes laktacioni	11	2	18.18
B- 118	Laktacion i hershëm	12	5	41.6
	Mes laktacioni	12	4	33.3
C- 102	Laktacion i hershëm	11	2	18.18
	Mes laktacioni	10	3	30.0
D - 85	Laktacion i hershëm	10	5	50.0
	Mes laktacioni	12	3	25.0
E – 176	Laktacion i hershëm	12	4	33.3
	Mes laktacioni	11	2	18.18
TOTALI		113 (57 + 56)	31 (17 + 14)	27.4 (29.8 + 25.0)

Tabela 1. Interpretimi i rezultateve për shpeshtësinë e gjendjes SARA në ferma të ndryshme me lopë për prodhim qumështi.

MATERIALI DHE METODA

Nga Shtatori deri në Dhjetor 2009, në pesë ferma u përzgjedhën në mënyrë rastësore nga dy grupe me 12 lopë, të racës Laramane e zezë. Njëri grup ndodhej në laktacionin e hershëm (ditët 3-30 të laktacionit), ndërsa grupi tjetër në mesin e laktacionit. Në grupet e lopëve në eksperiment u përfshinë individë në laktacionin e parë dhe lopë me më shumë se një laktacion. Kampionimet e

përmbajtjes së rumenit u bënë 4–6 orë pas marrjes së ushqimit dhe kontrollit klinik, nëpërmjet sondës nazo-ezofagale. Eksperimenti u krye në grupet e lopëve me dietë ushqimore të njëjtë. pH i lëngut ruminal u analizua me pH metër. Për të gjitha kafshët u vlerësua numri dhe cilësia e lëvizjeve peristaltike të rumenit, cilësitë e feceve (konsistenca, prania e pjesëzave ushqimore të patretura dhe e bulëzave të gazit),

temperatura e trupit dhe pH i urinës. Të njëjtat teste u përdorën për të diktuar diferencat në parametrat e studiuar si dhe për të krahasuar ndryshimet midis treguesve në grupin e kafshëve që kishin SARA dhe pjesës tjetër të grupit në laktacionin e hershëm dhe atyre në mesin e tij. Sipas Krause K.M. dhe Oetzel G.R. (2006) u konsideruan me gjendje SARA kafshët me pH 5,1-5,5, ndërsa kafshët me pH ndërmjet 5.6 dhe 5.8 u konsideruan të rrezikuara. Të dhënat e fituara u përpunuan statistikisht dhe u sqaruan bashkëlidhjet midis treguesve. Diferencat u konsideruan sinjifikative për $p < 0.05$.

Temperatura mesatare trupore		
Kafshët pa acidozë të rumenit	Kafshët me SARA	
	Në fillim të laktacionit	Në mes laktacioni
38.56 ± 0.15	38.57 ± 0.12	-
38.61 ± 0.14	-	38.74 ± 0.14

Tabela 2. Ndryshimet në temperaturën e trupit në grupet e kafshëve në studim të lidhura me praninë ose jo të gjendjes SARA.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Nga 120 lopë të përzgjedhura ishte e mundur të merrej lëngu ruminal në 113 (57 në laktacionin e hershëm dhe 56 në mesin e laktacionit). 31 lopë (27.43%) e kishin pH ruminal më pak se 5.5 në kohën e kampionimit të lëngut ruminal nga të cilat 17 krerë (29.82%) ishin në laktacionin e hershëm dhe 14 (25%) në mesin e laktacionit, tabela 1. Minimumi dhe maksimumi i vlerave të pH që u gjetën ishin respektivisht 5 dhe 6.5. Në kufirin e vlerave të pH ndërmjet 5.6 dhe 5.8 gjetëm 21 lopë (18.58%) nga të cilat 7 lopë (12.28%) në laktacionin e hershëm dhe 14 (25.0%) në mesin e laktacionit. Në kohën e kampionimit të përmbajtjes së rumenit, në grupin e lopëve në laktacionin e hershëm në katër ferma dhe në grupin e lopëve në mesin e laktacionit në të pesë fermat gjetëm individë me gjendje SARA, ose me $pH < 5.5$. Nga lopët në laktacion të hershëm në një fermë dhe lopët në mesin e laktacionit në dy ferma gjetëm dhe individë që ishin në kufijtë e acidozës së rumenit.

Nga të dhënat tona duket se nuk kishte ndikim të gjendjes së SARA në temperaturën e trupit në kafshë ($P = 0.558$) dhe se midis këtyre dy treguesve nuk kishte lidhje korrelative ($r = -0.068$), tabela 2. Për të vlerësuar ndikimin e gjendjes SARA në cilësinë e lëvizjeve peristaltike të rumenit, në konsistencën dhe cilësitë e feceve u bazuam në të dhënat e Kleen J.L. e bp. (2003) dhe Hughes J. (2001) të cilët rekomandojnë vlera të referencës. Të dhënat e fituara jepen në tabelen 3. Nga të dhënat tona duket se ka diferenca por jo të ndjeshme në numërin e lëvizjeve peristaltike të rumenit ($P = 0.455$) midis lopëve me gjendje SARA dhe lopëve klinikisht të shëndosha. Bashkëlidhjet korelative midis pH ruminal dhe lëvizjeve peristaltike të rumenit ishin të dobta dhe të karakterit negativ ($r = -0.361$). Ndikim më të dukshëm gjendja SARA në lopë kishte në uljen e forcës së realizuar të lëvizjeve peristaltike të rumenit. Gjendja e SARA ndikon dhe në cilësitë e feceve (tab. 3). Konsistencën gjysëm pastoze dhe pa formim rrathësh të feceve e konsideruam të ndikuar nga acidoza në grupet e lopëve me SARA në të dy fazat e laktacionit. Bulzat e gazit në fece mungonin në kafshët e shëndetshme dhe ishin të rralla në lopët me gjendje SARA. Pjësja ushqimore të patretura nuk gjetëm në fecet e lopëve të shëndetshme, ndërsa në fecet e lopëve me gjendje SARA të rumenit gjetëm të tilla (të rralla) dhe me përmasa 3-5 cm. Nuk kishte ndryshime sinjifikative ndërmjet grupit të lopëve me gjendje SARA dhe pjesës tjetër në pH e urinës ($P = 0.308$). Shpeshësia e gjendjes SARA në 113 kafshë në studim rezultoi 27.43% (29,82% e lopëve në fillimin e laktacionit dhe 25,0% në lopë në mesin e laktacionit). Vlera e shpeshësisë së acidozës së rumenit në studimin tonë rezultoi më e ulët sesa ajo e raportuar nga autorë të tjerë. Nga ekzaminimi i lopëve në 5 tufa të racës Holshtein, Garrett E.F. e bp. (1999) zbuloi praninë e SARA në 32.1% të lopëve në laktacionin e hershëm (3-30 ditë laktacion) dhe në 26,3% të lopëve në mesin e laktacionit (90–120 ditë laktacion). Ndikimi i SARA në temperaturën e trupit është i pakët, Oetzel G.R. (2005, 2003). Në studimin tonë (tab. 2), nuk është konfirmuar ndonjë diferencë

sinjifikative midis ndikimit ose jo të SARA në temperaturën e trupit në lopë. Pakësimi i numrit të lëvizjeve peristaltike të rumenit është shenjë klinike e SARA e cila është dokumentuar edhe nga Underwood (1992) dhe Enemark J.M. e bp. (2002). Megjithatë në studimin tonë nuk janë

konstatuar diferenca sinjifikative midis efektit ose jo të SARA në numrin e lëvizjeve peristaltike të rumenit (8,23 lëvizje peristaltike në 5 minuta kundrejt 8.1), tab. 3. Ndikim më të dukshëm vërejtëm në fortësinë e realizimit të tyre.

Treguesit	Vlerësimi në grupet e kafshëve		
	Kafshë pa acidozë	Kafshë me SARA	
		Në fillim të laktacionit	Në mes laktacioni
Lëvizjet peristaltike të rumenit	8.23 ± 1.14 në 5 min. me force normale	8.2 ± 1.1 në 5 min. me force mesatare	8.1 ± 0.9 në 5 min. me force mesatare
pH i urinës	8.7 ± 0.52	8.6 ± 0.71	8.6 ± 0.67
Konsistenca e feceve	Gjysëm pastoze me formim rrathësh	Gjysëm pastoze pa formim rrathësh	Gjysëm pastoze pa formim rrathësh
Prani bulza gazi në fece	Pa prani pulza gazi	Bulza të rralla	Bulza të rralla
Prani e pjesëzave të ushqimit të patretura në fece.	Pa pjesëza ushqimore të patretura	Prani e pjesëzave të rralla, të patretura	Prani e pjesëzave të rralla, të patretura

Tabela 3. Disa tregues klinikë të ndikuar nga gjendja e SARA në lopë

Në konsistencën dhe strukturën e feceve (tab. 3) gjetëm ndryshime të pakta të ndikuara nga gjendja SARA. Më të dukshme ndryshimet ishin në diferencat e pranisë së bulëzave të gazit dhe të pjesëzave nga ushqimet e patretura. Duke konsideruar faktin që SARA (sipas Oetzel G.R. e bp. 1999), është gjendje episodike dhe shpesh kalimtare, pa shenja të theksuara e të dukshme në të shumtën e rasteve, duket se ndryshime më shumë të dukshme në cilësitë e feceve shkaktohen nga çrregullime më të rënda ruminale sesa gjendja e SARA, Underwood W.J. (1992). Bazuar në të dhënat e studimin tonë, vlerësojmë se pH i urinës nuk duket i ndikueshëm dhe të përdoret për qëllime të identifikimit për SARA. Studimi nxorri në pah se gjendja SARA është problem i pranishëm në lopët e fermave tona dhe kërkon kontrolle periodike për diagnostikimin e hershëm.

PERFUNDIME

1. Gjendja e acidozës nënacute të rumenit (SARA) është problem i pranishëm në lopët e fermave tona, pavarësisht nga natyra e të ushqyerit dhe periudha e laktacionit.

2. Në lopët që vuajnë nga SARA nuk manifestohen shenja të dukshme klinike. Gjendja SARA në lopë nuk ka ndikim në temperaturën e trupit. Ndikim më të dukshëm SARA ka në fortësinë, numrin e lëvizjeve peristaltike të rumenit, konsistencën dhe treguesit e përmbajtjes së feceve. Këta tregues mundet të shfrytëzohen për diagnostikimin e hershëm të SARA në lopë.

3. pH i urinës nuk mundet të përdoret si provë për konstatimin e pranisë së gjendjes SARA në lopë.

BIBLIOGRAFIA

1. Enemark J.M.D; Jorgensen R.J. and Enemark P.S. (2002). - Rumen acidosis with special emphasis on diagnosis aspect of subclinical rumen acidosis. *Vet. Zootech.* Nr. 42, 16 -29.
2. Garrett E.F; Perreira M.N; Nordlund K.V. et al. (1999). – Diagnostic methods for the detection of subacute ruminal acidosis in dairy cows. *J. Dairy Sci.*, 82: 1170-1178.
3. Hughes J. (2001). - A system for assessing cow cleanliness. *In Prac.*, 40: 517-524.

4. Kleen J.L; Hooijer G.A; Rehage J. and Noordhuizen J.P.T. (2003). Subacute ruminal acidosis (SARA): a review. *J. Vet. Med. Series A*, 50: 406-414.
5. Krause K.M. and Oetzel G.R. (2006). - Understanding and preventing Anim. Feed Sci. Technol., 126: 215-236.
6. Nordlund K.V; Garrett E.F. and Oetzel G.R. (1995). - Herd-based rumenocentesis a clinical approach to the diagnosis of subacute rumen acidosis. *Compend. Contin. Educ. Pract. Vet.*, 17.
7. Oetzel G.R. (2005). - Applied aspects of ruminal acidosis induction and prevention. *J. Dairy Sci.*, (Suppl. 1), 88: 377.
8. Oetzel G.R. (2003). - Subacute ruminal acidosis in dairy cattle. *Adv. Dairy Sci. Tech.*, 15: 307-317.
9. Oetzel G.R; Nordlund K.V. and Garret E.F. (1999). - Effect of ruminal pH and stage of lactation on ruminal lactate concentration in dairy cows. *J. Dairy Sci.*, (Supple. 1), 82: 38.
10. Underwood W.J. (1992). - Rumen lactic acidosis. Part II. *Compend. Contin. Educ. Pract. Vet.*, 14: 1265-1270.

THE EFFECT OF FARINOSE AND PELLET FEED ON PRODUCTION PARAMETERS OF WEANED PIGLETS

NDIKIMI I PËRDORIMIT TË USHQIMIT NË FORMË TË MIELLËZUAR DHE TË PELETUAR MBI TREGUESIT PRODHUES TË GICAVE PAS KËPUTJES

ETLEVA DELIA^a, FLUTURA SALA^b, ENKELEJDA SALLAKU^a, FIDEL GJURGI^a

^aDepartamenti i Prodhimit Shtazor, Universiteti Bujqësor i Tiranës

^bDrejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Durrës, SHQIPËRI.

Email: etlevade@yahoo.com

AKTET IV, 1: 69 - 73, 2011

PERMBLEDHJE

Mënyra e përpunimit të ushqimeve të kafshët monogastrike ndikon dukshëm në densitetin dhe popullacionin mikrobial në stomak dhe zorrë. Qëllimi i këtij studimi ishte të provohej efektiviteti i përdorimit të ushqimit të peletuar te gicat si dhe të evidentohej ndikimi i tij mbi treguesit prodhues, si peshën e gjallë (kg), dinamikën e shtesës së peshës (g/ditë), shpërblimin e ushqimit (kg ushqim/kg shtesë peshe). Faktori studimor i ndryshueshëm ishte forma e dhënies së ushqimit, e studjuar përmes dy mënyrave: të miellëzuar dhe të peletuar. Pas 6 javë periudhë eksperimentale grupi i trajtuar me ushqim të peletuar ka patur një ecuri më të mirë të peshës së gjallë, që sipas javëve rezultojnë: 7.5%, 10.7%, dhe 10.3% më e lartë krahasuar me grupin e kontrollit. Të njëjtën ecuri ka patur edhe dinamika e shtesës së peshës, e cila për grupin e eksperimentit ka qenë: 36.2%, 20.5%, 9.1% më e lartë, krahasuar me kontrollin.

Fjalë kyçe: gica, ushqim i peletuar, treguesit e rritjes.

SUMMARY

Feed processing used on non ruminant's animal like pigs and poultry is one of the common studied field. The main objective of this study was to investigate the effects of pellet feed on performance parameters: body live weight (BLW), daily weight gain (DWG) and feed conversion ration (FCR) of piglets, in extensive farm conditions. The utilization of pellet feed improved growth parameters, average live weight (kg), daily weight gain g/day and feed conversion ration (FCR), compare to the control group. During the experimental period, the group treated with pellet feed had a higher average live weight, 7.5%, 10.7%, and 10.3% respectively. The average daily weight gain had the same tendency: 36.2%, 20.5% and 9.1% higher to compare with control group. Based on the achieved results, it could be concluded that the utilization of pellet feed lead to an improvement of the production parameters in piglets, especially in extensive farm conditions.

Key words: piglets, pellet feed, granulated feed, performance parameters.

HYRJE

- spërkatja e tretë, Bavistinë 0.05%. 26.04.2010
- spërkatja e katërt, Captan 80 WG 0.15 % + Squfur. 8.05.2010
- spërkatja e pestë, Score 250 EC 0.015% + Captan 80 WG 0.15 %. 26.05.2010
- spërkatja e gjashtë, Zato 0.015%+Captan 80W 0.15 %. 2.06.2010
- spërkatja e shtatë, Zato 0.015%+ Antrakol 70 WP. 13.06.2010
- spërkatja e tetë, Captan 80 WG 0.15 % +Zato 0.015%. 23.06.2010

U përdorën tre lloje mjetesh spërkatëse:

Pompë motorike hidropneumatike me ventilator të tërhequr me traktor “LOGE”, me kapacitet mbajtës 10 kv solucion, me 14 sprucatorë. Disku i sprucatorit 1.2 mm. Presioni i pompës gjatë

punës 25 atmosferë. Numri i xhirove të ventilatorit të pompës gjatë spërkatjes, 2000/min.

Pompë motorike e varur në traktor tip “Termit”-300. Më dy stëka dhe disk të sprucatorit, 1.2 mm. Presioni i pompës gjatë spërkatjes, 25 atmosferë.

Pompë shpine e zakonshme tip “OMR”. Kapaciteti 20 litra solucion, presioni i pompës gjatë punës 1 atmosferë, disku i sprucatorit 1.2 mm

Shkalla e prekjes është llogaritur me anën e formulës :

$$P = n \times 100 / N$$

Ku : P = shkalla e prekjes.

n = numri i gjetheve ose kokrrave të prekura nga kroma.

N = numri total i gjetheve të analizuar për çdo variant.

Për çdo variant përcaktohet katëgoria në bazë të sipërfaqes gjethore të prekur nga kroma.

Katëgoria

0. Praktikisht asgjë. 0% e sipërfaqes së gjethes ose kokrrës e prekur.

1. Intensitet i lehtë. 0-5% e sipërfaqes së gjethes ose kokrrës e prekur.

2. Intensitet i mesëm. 5-15% e sipërfaqes së gjethes ose kokrrës e prekur.

3. Intensitet i fortë. 15-30% e sipërfaqes së gjethes ose kokrrës e prekur.

4. Intensitet shumë i fortë. 30-45% e sipërfaqes së gjethes ose kokrrës e prekur.

5. Intensitet shkatërrues. Mbi 45% e sipërfaqes së gjethes ose kokrrës e prekur.

Intensiteti i prekjes është llogaritur nëpërmjet formulës së Mckinney.

$$i = \frac{\sum(n_{xk})}{N \times K} \times 100$$

Ku :

i = indeksi i prekjes nga sëmundja.

\sum = shuma e prodhimit.

n = numri i gjetheve ose kokrrave sipas kategorisë.

k = numri i çdo katëgorie.

N = numri i gjithë gjetheve ose kokrrave të analizuar.

K = numri gjithsej i katëgorive.

Pas përlogaritjes bëhet përpunimi statistikor për shkallën e vërtetësisë së të dhënave.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI I TYRE

A. Shkalla e intensitetit të prekjes nga kroma në kokërr

Gjatë analizave të kokrave rezultuan këto të dhëna për intënsitetin e prekjes nga kroma në

kokërr, sipas tabelës nr. 1. -Vlerat e shpërndarjes “F” për të dy faktorët A dhe B si dhe bashkëveprimin $A \times B$ janë: “F”_A = 39.7, “F”_B = 833.5, “F”_{AxB} = 7.5

Lloji i pompës	Faktori B→ Faktori A↓	b ₁	b ₂	Shuma (Σa _i)	Mesat. e (a _i)
		Golden delicious	Starking		
Pompë hidropneum. me ventilator	a ₁	0	14	-	-
		0.5	15.6		
		0.66	14.6		
	Σa ₁	1.16	44.20	45.36	7.56
Pompë “Tërmit-300”	a ₂	1.83	16.1	-	-
		2.83	17.3		
		3.83	17		
	Σa ₂	7.99	50.40	58.39	9.73
Pompë shpine “OMR”	a ₃	5.66	21.8	-	-
		6.33	20.6		
		4.83	18.6		
	Σa ₃	16.82	61	77.82	13
-	Shuma(Σb _i)	25.97	155.6	181.57	-
	Mesat.e (b _i)	29	17.3	-	-

Tabela 1. Shkalla e intensitetit të prekjes nga kroma në KOKËRR

Lloji i pompës	Faktori B→ Faktori A↓	b ₁	b ₂	Shuma (Σa _i)	Mesat. e (a _i)
		Golden delicious	Starking		
Pompë hidropneum. me ventilator	a ₁	16	16.6	-	-
		14.3	13.3		
		15.6	17.1		
	Σa ₁	45.9	47	92.9	15.5
Pompë “Tërmit-300”	a ₂	15.6	18	-	-
		19.1	17		
		17.8	14.6		
	Σa ₂	52.5	49.6	102.1	17
Pompë shpine “OMR”	a ₃	20.1	20.1	-	-
		22.5	20.3		
		18.6	18.1		
	Σa ₃	61.2	58.5	119.7	19.95
-	Shuma(Σb _i)	159.6	155.1	314.7	-
	Mesat.e (b _i)	17.73	17.23	-	-

Tabela 2. Shkalla e intensitetit të prekjes nga kroma në GJETHE

“F” e llogaritur për faktorin A në nivelin propabilitar 95% dhe 99% janë: “F”_{0.05}= 3.89 dhe “F”_{0.01}= 6.93, për faktorin B janë : “F”_{0.05}=4.75 dhe “F”_{0.01}=9.33. Për faktorët e bashkëveprimit AxB janë: “F”_{0.05}=19.4 dhe “F”_{0.01}=99.4

Meqënëse “F” praktike për të dy nivelet probabilitare (“F”_{0.05} dhe “F”_{0.01}), për faktorin e bashkëveprimit AxB janë më të vogla se ato tabelare, nuk vërtetohet statistikisht, bashkëveprimi midis dy faktorëve A dhe B nuk ekziston.

Lloji i pompës	Faktori B→ Faktori A↓	b ₁ Golden delicious	b ₂ Starking	Shuma (Σa _i)	Mesat. e (a _i)
Pompë hidropneum. me ventilator	a ₁	0	42	-	-
		3	43		
		4	41		
	Σa ₁	7	126	133	22.2
Pompë “Tërmit-300”	a ₂	5	45	-	-
		6	49		
		10	47		
	Σa ₂	21	141	162	27
Pompë shpine “OMR”	a ₃	3	54	-	-
		6	54		
		11	51		
	Σa ₃	20	159	179	30
-	Shuma(Σb _i)	48	426	474	-
	Mesat.e (b _i)	5.3	47.3	-	-

Tabela 3. Shkalla e prekjës së kromës në KOKËRR

Lloji i pompës	Faktori B→ Faktori A↓	b ₁ Golden delicious	b ₂ Starking	Shuma (Σa _i)	Mesat. e (a _i)
Pompë hidropneum. me ventilator	a ₁	38	36	-	-
		35	33		
		37	35		
	Σa ₁	110	104	214	35.7
Pompë “Tërmit-300”	a ₂	39	44	-	-
		42	41		
		40	37		
	Σa ₂	123	122	245	40.8
Pompë shpine “OMR”	a ₃	46	50	-	-
		49	47		
		54	46		
	Σa ₃	139	143	282	47
-	Shuma(Σb _i)	372	369	741	-
	Mesat.e (b _i)	41.3	41	-	-

Tabela 4. Shkalla e prekjës së kromës në GJETHE

Ndërsa “F” praktike për të dy nivelet probabilitare (“F”_{0.05} dhe “F”_{0.01}), për dy faktorët A dhe B janë më të mëdha se ato

tabelare, vërtetohen statistikisht, atëherë llogaritem DMV. Për faktorin A: DMV_{0.05} = 1.34 dhe DMV_{0.01} = 1.86

Diferencat ndërmjet mesatareve për mjetët spërkatëse që janë më të mëdha se DMV vërtëtohen statistikiisht. Nga kjo rezulton se intënsiteti më i ulët i prekjës së kokrrave nga kroma paraqitet në mollët e trajtuara me pompë hidropneumatike me ventilator

Për faktorin B: $DMV_{0.05} = 1.1$ dhe $DMV_{0.01} = 1.52$

Nga krahasimi rezulton se Golden delicious ka shkallë intënsiteti të prekjës nga kroma në kokërr më të ulët se kultivari Starking.

B. Shkalla e intënsitetit të prekjës nga kroma në GJETHE

Gjatë analizave të gjetheve rezultuan këto të dhëna për intënsitetin e prekjës nga kroma në gjethe sipas tabelës nr. 2.

-Vlerat e shpërndarjes "F" për të dy faktorët A dhe B si dhe bashkëveprimin AxB janë: $"F"_{A} = 11.2$, $"F"_{B} = 2.46$, $"F"_{AxB} = 3.3$

"F" e llogaritur për faktorin A në nivelin propabilitar 95% dhe 99% janë: $"F"_{0.05} = 3.89$ dhe $"F"_{0.01} = 6.93$, për faktorin B janë: $"F"_{0.05} = 19.4$ dhe $"F"_{0.01} = 99.4$. Për faktorët e bashkëveprimit AxB janë: $"F"_{0.05} = 19.4$ dhe $"F"_{0.01} = 99.4$

Meqënëse "F" praktike për të dy nivelet probabilitare ($"F"_{0.05}$ dhe $"F"_{0.01}$), për faktorin e bashkëveprimit AxB janë më të vogla se ato tabelare, nuk vërtëtohet statistikiisht.

Ndërsa "F" praktike për ($"F"_{0.05}$ dhe $"F"_{0.01}$), për dy faktorët A dhe B janë më të mëdha se ato tabelare, vërtëtohen statistikiisht, prandaj llogarisim DMV

Për faktorin A: $DMV_{0.05} = 2.11$ dhe $DMV_{0.01} = 2.97$

Diferencat ndërmjet mesatareve për mjetët spërkatëse që janë më të mëdha se DMV vërtëtohen statistikiisht. Nga të dhënat rezulton se me pompat spërkatëse hidropneumatike me ventilator dhe Tërmit sigurohet një infeksion me shkallë intënsiteti më të ulët në gjethe, se me pompat e shpinës.

F_B praktike=2.46, ndërsa $F_{B, 0.05}$ teorike =19.4 dhe për $F_{B, 0.01}$ teorike = 99.4. Kështu $2.46 < 19.4$ dhe $2.46 < 99.4$. Në këtë mënyrë nuk vërtëtohet ndryshueshmëria për faktorin B (varietetët).

C. Shkalla e prekjës së kromës në KOKËRR

Gjatë analizave të kokrrave rezultuan këto të dhëna për shkallën e prekjës nga kroma në kokërr sipas tabelës nr. 3.

-Vlerat e shpërndarjes "F" për të dy faktorët A dhe B si dhe bashkëveprimin AxB janë: $"F"_{A} = 15$, $"F"_{B} = 1323$, $"F"_{AxB} = 3.5$

"F" e llogaritur për faktorin A në nivelin propabilitar 95% dhe 99% janë: $"F"_{0.05} = 3.89$ dhe $"F"_{0.01} = 6.93$, për faktorin B janë: $"F"_{0.05} = 4.75$ dhe $"F"_{0.01} = 9.33$. Për faktorët e bashkëveprimit AxB janë: $"F"_{0.05} = 19.4$ dhe $"F"_{0.01} = 99.4$

Meqënëse "F" praktike për të dy nivelet propabilitare ($"F"_{0.05}$ dhe $"F"_{0.01}$), për faktorin e bashkëveprimit AxB janë më të vogla se ato tabelare, nuk vërtëtohet statistikiisht.

Ndërsa "F" praktike për ($"F"_{0.05}$ dhe $"F"_{0.01}$), për dy faktorët A dhe B janë më të mëdha se ato tabelare, vërtëtohen statistikiisht, atëherë llogarisim DMV.

Për faktorin A: $DMV_{0.05} = 3$ dhe $DMV_{0.01} = 4.4$

Diferencat ndërmjet mesatareve për mjetët spërkatëse që janë më të mëdha se DMV vërtëtohen statistikiisht. Nga të dhënat rezulton se në pemët e trajtuara me pompa spërkatëse hidropneumatike me ventilator shkalla e përhapjes së kromës së mollës në kokërr është më e ulët se dy variantët e tjera.

Për faktorin B: $DMV_{0.05} = 2.4$ dhe $DMV_{0.01} = 3.6$

Diferencat ndërmjet mesatareve për kultivarët që janë më të mëdha se DMV vërtëtohen statistikiisht. Nga përpunimi i të dhënave rezulton se kultivari Golden delicious ka shkallë të përhapjes së kromës në kokërr më të ulët se kultivari Starking.

D. Shkalla e prekjës së kromës në GJETHE

Gjatë analizave të gjetheve rezultuan këto të dhëna për shkallën e prekjës sipas tabelës nr. 4.

-Vlerat e shpërndarjes "F" për të dy faktorët A dhe B si dhe bashkëveprimin AxB janë: $"F"_{A} = 2.63$, $"F"_{B} = 146$, $"F"_{AxB} = 15.3$

"F" e llogaritur për faktorin A në nivelin propabilitar 95% dhe 99% janë: $"F"_{0.05} = 3.89$ dhe $"F"_{0.01} = 6.93$, për faktorin B janë: $"F"_{0.05} = 244$ dhe $"F"_{0.01} = 320$. Për faktorët e

bashkëveprimit $A \times B$ janë : " F " $_{0.05}$ =19.4 dhe " F " $_{0.01}$ =99.4

Meqenëse " F " praktike për (" F " $_{0.05}$ dhe " F " $_{0.01}$), si për faktorin A, faktorin B dhe faktorin e bashkëveprimit $A \times B$ janë më të vogla se ato tabelare, nuk vërtëtohen statistikiisht, pra si faktori A dhe faktori B nuk bëhen burim ndryshueshmërie si dhe bashkëveprimi midis dy faktorëve A dhe B nuk ekziston.

4. PËRFUNDIME

1. Trajtimet kimike me pompat spërkatëse hidropneumatike me ventilator sigurojnë infeksione nga kroma në kokërr me intënsitet më të ulët se pompat hidraulike "TERMIT" dhe pompat e zakonshme të shpinës, pasi madhësia e piklave spërkatëse është më e vogël dhe shpërndarja e tyre në pemë është uniforme dhe e plotë.

2. Kultivari Starking paraqitet me intënsitetin e prekjes se kokrrave nga kroma në nivelin më të lartë se kultivari Golden delicious.

3. Trajtimet kimike me pompat spërkatëse hidropneumatike me ventilator dhe pompat hidraulike "TERMIT" sigurojnë infeksione nga kroma në kokërr me intënsitet më të ulët se pompat e zakonshme të shpinës .

4. Shkalla e përhapjes së kromës në kokërr është më e lartë në kultivarin Starking dhe në pemët e trajtuara me pompë shpine se sa pemët e trajtuara me dy tipet e tjera të pompave.

5. Të tre tipet e pompave spërkatëse me trajtimet kimike paraqesin thuajse rezultatë të njëjta në shkallën e përhapjes së kromës në gjethe në të dy llojet e kultivarëve.

6. Bashkëveprimi i të dy faktorëve: pompat spërkatëse dhe kultivarët nuk paraqesin ndryshim në shkallën dhe intënsitetin e prekjes nga kroma.

5. BIBLIOGRAFI

1. Kaltani T., Çelo B.: (1982) Fitopatologjia e përgjithshme.
2. Isufi E.: (1997). Mbrojtja e integruar e bimëve.
3. Xhuveli L., Salillari A.: (1984). Bazat e eksperimentimit shkencor në bujqësi.
4. Kolaci A. (1997). Manual i Fitofarmacisë.
5. Qirjo Th. (2002). Makineritë bujqësore. .

STUDY OF THE FLOWER AND BLOOM CHARACTERISTICS IN SOME OLIVE CULTIVARS (*Oliva europaeae*) STUDIMI I DISA KARAKTERISTIKAVE TË LULËRISË DHE LULES NË DISA KULTIVARË ULLIRI (*Oliva europaeae*)

FADIL THOMAJ

Universiteti Bujqësor, Departamenti i Hortikulturës, Tiranë, Shqipëri

Email: fadilthomaj@hotmail.com

AKTET IV, 1: 123-129, 2011

PERMBLEDHJE

Nga shumë studime të kryera ndër vite është bërë e mundur që sot të disponojmë një katalog në të cilin jepet karakterizimi i kultivarëve tanë autoktonë, bazuar në grumbullimin e shumë të dhënave biometrike të frutit, gjethes, bërthamës dhe lulërisë. Në studimin tonë dyvjeçar kemi synuar që të gjejmë ndryshimet ose ngjashmëritë midis një grupi kultivarësh të ullirit (*O.europaeae*), bazuar në analizën morfologjike e fiziologjike të lulërisë dhe lules. Nga studimi rezultoi se forma e krezës dhe shtyllëzës janë karakteristika gjenetike të kultivarit. Ato mund të shërbejnë si karaktere dalluese për të veçuar forma e biotipe interesante brenda një kultivari-popullatë. Niveli i abortimit të vezores dhe tipi i abortimit kanë vartësi gjenetike por ndikohen dhe nga faktorë të tjerë (kushtet e kultivimit, ngarkesa me prodhim, faktorët klimatikë etj.) që ndikojnë drejtpërdrejtë ose në mënyrë indirekte mbi gjëndjen fiziologjike të bimës.

Fjalë kyçe: germoplazmë, kultivar, lulëri, abortim i vezorit.

SUMMARY

Of the many studies done over the years it has become possible today to possess a catalog in which is given a characterization of our native cultivars, based on the collection of many biometric data of the fruit, leaf, bloom and nucleus. In our two years study we have aimed to find differences or similarities between a group of olive cultivars (*O. europaeae*), based on morphological and physiological analysis of the bloom and flower. From the study results that the shape of stigma's stylus are genetic features of the cultivar. They can serve as distinctive characters to pick out interesting biotypes and shapes within a cultivar-population. The level of ovary abortion and the abortion type have genetic dependency but are influenced by other factors (cultivation conditions, production loads, climatic factors etc.) that affect directly or indirectly on plant physiological status.

Keywords: germoplasma, cultivar, bloom, ovary abortion

HYRJE

Pasuria e madhe varietore e ullishtëve tona, ku rreth 90% e kultivarëve janë autokton, nxjerr në pah domozdoshmërinë e studimeve të thelluara në shumë aspektë ende të panjohura, si biologjia e lulëzimit dhe frutifikimit, identifikimi më i plot i kultivarëve etj. Disa karakteristika të lulërisë si struktura, forma, madhësia etj. përdoren për përshkrime dhe identifikime të kultivarëve duke

qënë se paraqesin një stabilitet fenotipik. Megjithatë, shpesh është gjetur një ndryshueshmëri e madhe dhe brënda kultivarit sidomos nga njëri vit në tjetrin (Bartolini-Guerriero, 1995; Lombardo-Ciliberti, 1987; Thomaj-Panajoti, 1998)

Për unifikimin e përshkrimit të lulërisë Nigond (1974) propozon strukturën tridimensionale, gjë që e lehtëson shumë punën e pomologjistëve dhe

kjo duket nga referimet që i bëhen nga studiues në fushën e biologjisë lulore të ullirit. (Bartolini-Guerriero, 1995; Lombardo-Ciliberti, 1987; Thomaj-Panajoti, 1998, Cimato 1980 etj.).

Abortimi i vezores është shpesh shkaku i pakësimit të prodhimit në disa kultivarë. Lule të abortuara janë ato me pistil atrofik, të nekrotizuar, të zverdhur, ose me vezore të pajetë. Arsyet e mungesës së organit femëror në pjesën më të madhe janë me karakter gjenetik (De Michele 1973; Lombardo 1987).

Më parë mendohej se aborti i luleve shkatohej vetëm nga mungesa e lëndëve azotike e në përgjithësi nga mungesa e kushteve të nevojshme klimatike. Studimet e bëra kanë vërtetuar se dështimi në rradhë të parë është një veçori varietore, pasi në kultivarë të ndryshëm në kushte të barabarta rritjeje, fenomeni i abortit nuk është i njëlojtë dhe lëviz nga 10% deri 60% (Lombardo-Ciliberti, 1987; Thomaj-Panajoti, 1998)

Studime të tjera edhe më të thelluara të kryera për specie frutore dëshmojnë se karakteristika të krezës, kokrrizës pjalmike etj. mund të shërbejnë gjithashtu si mjet identifikimi për kultivarë të ndryshëm (Cresti 1985; Hava 2005).

Në këtë kuadër, qëllimi i këtij studimi ishte që të gjejmë ndryshimet ose ngjashmëritë midis një grupi kultivarësh të ullirit (*O. europaea*), bazuar në analizën morfologjike e fiziologjike të lulërisë dhe lules.

MATERIALI DHE METODA

Eksperimenti është ngritur në zonën e Selitës dhe Saukut.

Kultivarët e marrë në studim: U morën në studim Kultivarët: Boç, Ulli i bardhë i Tiranës, Ulli i zi, Kalinjot, Olivastër e kuqe, Frantoio, Franxhivento, Ullastër e Zezë.

Për secilin kultivar u zgjodhën nga pesë bimë të moshës 40-50 vjeçare, me një gjëndje pothuaj të barabartë për nga zhvillimi dhe gjëndja shëndetësore. Mbi çdo bimë që në fakt përfaqëson një përsëritje u etiketuan nga 12 degëza frutore të shpërndara në gjithë volumin e kurorës. Zgjedhja e tyre u bë në mënyrë të rastësishme në të gjithë volumin e kurorës.

Lartësia e marrjes së kampioneve u krye në lartësinë rreth 2.5m -3 m nga toka, ku veprohet më lirshëm dhe pa nevojën e mjetëve ndihmëse. Për secilën bimë të marrë në studim u ndoqën treguesit e mëposhtëm:

1. Biometria e lules. Për këtë tregues u morën nga 100 lulëri për çdo bimë dhe në total rreth 300 lulëri. Mbi to u kryen matjet për gjatësinë e lulërisë dhe gjërësinë e saj . Për gjërësinë u kryen matjet në degëzimin e fundit të saj ku arrihet dhe diametri tërthor më i madh.

2. Tipologjia e lules sipas modelit “Nigond”. Mbi kampionet e marra u kryen numërimi i luleve që ka çdo lulëri dhe shpërndarja e tyre sipas modelit Nigond. Ky model merr parasysh shpërndarjen e luleve në tre rende.

3. Shkalla e abortimit të vezorit. Sasia e mësipërme e lulërive ju nënshtrua një analize një për një lidhur me abortimin e vezorit. Vezoret e abortuara janë të pazhvilluara ose të përthithura nga shtrati i lules, zakonisht me ngjyrë kafe të errët; mund të jenë të zhvilluara pjesërisht por ngelen të pa përsosura dhe mbetën me ngjyrë të verdhë. Rasti i tretë është zhvillimi pothuaj normal i vezorit por mungesa e shtyllzës dhe krezës çon në mungesë të proceseve normale të pjalmimit dhe pllenimit, ndaj konsiderohen lule të abortuara.


4. Forma e krezës dhe shtyllzës; Mbi 100 lule të çdo kultivari u bënë vrojtme në stëriomikroskop për të parë nivelin e përsosmërisë së organeve të lules si dhe për të evidentuar shmangiet e mundëshme nga forma tipike që mbizotëron të specia *Olea europaea*. Përmes kësaj analize dëshironim të gjenim ndryshimet morfoanatomike të organeve të lules për kultivarë të veçantë. Sot ato gjithnjë e më shumë krahas markerëve gjenetik që janë të kushtueshëm, po përdoren si tipare bazë për karakterizimin e formave e biotipeve të veçanta të ullirit (Cresti 1985; Hava 2005).

5. Anomalitë e mundëshme në morfologjinë e lules. Krahas treguesve të mësipërm gjatë analizimit të luleve u veçuan lulet që kishin ndryshime në ndërtimin morfologjik (numri i ndryshëm i petlave, mungesa e krezës etj.)


DISKUTIMI I TË DHËNAVE

1- Biometria e lulërisë.

Nga të dhënat e grumbulluara për dy vjet rresht rezulton se kultivarët e marrë në studim mund të grupohen në tre grupe për madhësinë e lulërisë (kranthit). Në grupin e parë me lulëri të madhe futën; Ullastra e zezë, Frantoio, Fraxhivento dhe Kalinjot (d, f, g, h). Në grupin e dytë me lulëri mesatare futën; kultivarët U.Bardhë i Tiranës, Ulli i zi dhe Olivastra e kuqe (b, c, e). Në grupin e tretë me lulëri të vogël ngelet vetëm kultivari Boç(a) Grafiku 1, 2, 3.




Grafiku 1. Paraqitja grafike e përmasave të lulërisë për kultivarët e studjuar




Grafiku 2. Niveli i ndryshueshmërisë për gjatësinë e kranthit (për kultivarët U.izi & Ol.e kuqe; Kalinjot & Frantoio nuk ka ndryshime sinjifikative)

Duke ju referuar ndryshimeve midis kultivarëve, gjejmë se grupet homogjene nuk janë të njëjta si për gjatësinë e kranthit dhe për gjërësinë e kranthit çka flet për një ndryshueshmëri të qëndrueshme midis kultivarëve. Grafiku 2, 3. Përsa i përket numrit të luleve për një lulëri duhet thënë se përgjithësisht vrehet një lidhje e


drejtë midis madhësisë së lulërisë dhe numrit të luleve në lulëri.



Grafiku 3. Niveli i ndryshueshmërisë për gjërësinë e kranthit (Për kultivarët Boç&U.B.Tiranës; Fraxhivento& Ullastër e zezë nuk ka ndryshime sinjifikative)




Grafiku 4. Numri i luleve për lulëri për kultivarët e studjuar



Grafiku 5. Niveli i ndryshueshmërisë për numrin e luleve/lulërisë

Megjithatë, rikonfirmojmë se përmasat e lulërisë dhe numri i luleve në lulëri ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin, madje shpesh në kufij të gjërë (Cimato, '80; Lombardo et al, '87; Thomaj et al. '98). Në këto ndryshime ndikojnë shumë faktorë, por ai më i rëndësishmi është ngarkesa me prodhim në vitin paraardhës. Kësisoj në vegetacionin e vitit 2007 që vintë pas një viti me prodhim të bollshëm për shumicën e kultivarëve të studjuar gjetëm një numër më të vogël të luleve për lulëri.



Grafiku 6. Ndryshimi i numrit të luleve nga njëri vit në tjetrin.




Foto 1. Karakteristikat strukturale të lulërive për kultivarët e studjuar.

Siç shihet numër më të madh të luleve për lulëri në vitin 2007 kanë patur kultivarët Boç dhe Franchivento të cilët në vitin e mëparshëm patën një prodhim më të pakët. Më të qëndrueshëm paraqitën kultivarët Ull i Bardhë, Kalinjot dhe Frantoio, ndonëse në lidhje të frutave edhe këta kultivarë ndoqën rregullsinë e kultivarëve të tjerë. Kjo dëshmon se përcaktues janë faktorët fiziologjik në induksionin dhe diferencimin vjetor të lules.

Nisur nga përmasat e lulërisë dhe numrit të luleve/lulëri, përcaktohet dhe niveli i shkrifmërisë së lulërisë i cili i grupon kultivarët e studjuar si më poshtë:

a- Me lulëri të ngjeshur ku futen Ull i bardhë dhe Ull i zi.

b- Me lulëri mesatarisht të ngjeshur ku futen kultivarët Kalinjot dhe Frantoio.

c- Me lulëri të shkrifët ku futëm kultivarët; Franchivento, Ullastër e zezë dhe Olivastër e Kuqe.

d- Me lulëri shumë të shkrifët ku futet kultivari Boç. Foto.1

2- Tipologjia e lulërisë dhe niveli i abortimit të luleve.

Lulëria e ullirit është tip veshuli (kranth) dhe ka një ndërtim tredimensional i cili është paraqitur skematikisht për herë të parë nga Nigond (1974) dhe i referohen gjithë studjuesit që okupohen me biologjinë lulore të ullirit. Fig 1. Në këtë strukturë tredimensionale është gjetur dhe nga autorë të tjerë se pjelloria e lules lidhet ngusht me natyrën

e degëzimit të lulërisë dhe dëndësinë e luleve (De Michele et al. 1973; Lombardo et al, '87).





Figura 1. Ndërtimi tridimensional i lulërisë sipas Nigond

- I - rendi i parë - përbëhet nga lulja e majës së aksit kryesor,
- II - rendi i dytë përbëhet nga lulet anësore që dalin direkt nga aksi kryesor dhe ato të ekstremeve nga akset e dyta.
- III- rendi i tretë përbëhet nga pjesa tjetër e luleve që ndodhet në brëndësi.
- IV- lule suplementare
- V- Aksi i lulërisë



Grafiku 8. Niveli i abortimit të vezorit sipas rendeve të propozuar nga Nigond

Nga shqyrtimi i të dhënave të përfthuara në studimin tonë për këtë kultivar rezulton se niveli më i lartë i abortimit të vezorit është gjetur tek Ulliri i zi, Franxhivento dhe Olivastër e kuqe, ndërsa niveli më i ulët i abortimit u gjet tek Ullastra e zeze dhe Boç graf.7. Po ashtu theksojmë se niveli më i lartë i abortimit u gjet në lulet e rendit të dytë dhe të tretë. Në lulet e rendit të parë u gjet një nivel i papërfillshëm i abortimit të vezorit që luhet nga 0.2 % tek U.B i Tiranës, Frantoio, deri në 3.2% tek , Olivastër e kuqe.

Kjo dëshmon se në nivelin e rendit të dytë dhe të tretë ku ndodhen masa kryesore e luleve të një lulërie konkurenca për lëndë ushqimore dhe hormonale gjatë formimit dhe përsosjes së lules bën që të formohen vezore me difektë. Graf.8

Anomalitë e mundëshme në morfologjinë e lules.

Tre janë rastet më frekvente të anomalive të lules tek ulliri që çojnë në abortimin e saj, apo formimin e *“luleve mashkullore”*:

- Pistili dhe vezorja mund të jenë krejtësisht të atrofizuara.(foto 2-1)
- Vezorja dhe pistili arrijnë në një stad zhvillimi paksa të avancuar por nuk arrijnë në përsosjen e tyre(2-2)
- Vezorja arrin të zhvillohet plotësisht, shtyllëza po ashtu por mungon krejtësisht kreza. (2-3)



Grafiku 7. Niveli i abortimit të vezorit për kultivarët e studjuar



Foto 2. Rastet e ndryshme të abortimit të vezorit dhe formimit të “luleve mashkullore” të lulja e ullirit

Morfologjia e lules së ullirit duket se është uniforme në gjithë specien *Olea europaea*, por në disa rastë shfaqen dhe lule anormale nga pikpamja morfologjike. Dukuria më e shpeshtë e gjetur gjatë studimit ishte prania e luleve me pesë petla. Kjo dukuri u gjet më shpesh tek kultivari Ulli i bardhë i Tiranës. Foto 3.



Foto 3. Anomalitë morfologjike tek lulja e ullirit, ku më e shpeshta është formimi i pesë petlava nga katër që është normalja.

4. Formae krezës dhe e shtyllzës.

Nga analiza mikroskopike e kampionaturave për kultivarët e marrë në studim rezultoi se forma e krezës është mjaftë specifike për secilin kultivar . Kjo dëshmon se ajo përbën një karakter të mundshëm dallues për forma e biotipe të ndryshme të bimëve të ullirit që mund të ndodhen në një ullishtë ose në një zonë karakteristike për një *kultivarë popullatë*. Një dukuri e tillë vrehet qartë tek kultivarët Boç dhe Frantoio të cilët paraqesin një polimorfizëm të formës së krezës. foto 4.




Foto 4. Format e ndryshme të krezës për kultivarët e marrë në studim.

Sipas formës së gjetur për krezën, kultivarët e marrë në studim mund ti grupojmë:

- Formë zemre (Olivastra e kuqe)
- Formë limoni (kultivari Ulli i zi, Boç)
- Formë patkoi (Ulli i bardhë)
- Formë bisht peshku me lobe të theksuara(Franxhivento, Frantoio)
- Formë bisht peshku i pa lobëzuar(Ullastër e zezë)
- Formë “U” (Kalinjot)

Përsa i përket karakteristikave të shtyllzës kultivarët e studuar mund ti grupojmë si më poshtë:

- Shtyllzë e shkurtër dhe e trashë (Ulli i zi, Olivastër e kuqe, dhe Ullastër e zezë)
- Shtyllzë mesatare (Boç, Ulli i Bardhë, Franxhivento, Frantoio)
- Shtyllzë e hollë dhe e gjatë (Kalinjot)

PËRFUNDIME

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme arrijmë në përfundim se:

- Dimensionet e lulërisë dhe numri i luleve paraqitën specifike për secilin kultivar si një tipar me karakter gjenetik të qëndrueshëm.
- Niveli i abortimit të vezorit është gjithashtu karakteristikë e kultivarit.
- Niveli më i lartë i abortimit të vezorit ndodh në lulet e rendeve të dytë dhe të tretë.
- Forma e krezës dhe shtyllzës janë karakteristik gjenetike e kultivarit. Ato mund të shërbejnë si

karaktëre dalluese për të veçuar forma e biotipe
intëresantë brenda një kultivari-popullatë

LITËRATURA

1. Bartolini S.Guerriero R.etj. 1995.
Carattërizazione morfo-biologica e produttiva di
tre intëresanti cloni della cultivar” Leccino di
recentë selezione.”(161 -166) Atti del convegno
”L’olivicoltura Mediterranea
2. .Cimato A. 1980 ; Osservazioni su alcuni aspetti
dela biologia fiorale e di fruttificazione della
cultivar di olovo “ Frangivento” in impianti ad
elevata densita. Riv. Ortoflorofrut. It.
3. Cresti M. Etj 1985 Caratteristiche morfologiche
dello stigma di alcune piante da fruto. Riv.
Ortoflorofrut. 69
4. De Michele A. Etj 1973 Indagini biennali sull
aborto, sull’allegagione e sulla cascola di alcune
varietà di olivo da mensa e da olio. Riv.
Tëc.agricola nr4-5
5. Hava F. 2005 Carattëristiche strutturali e
fisiologiche del fiore che influenzano la
produzione di olive
6. Lombardo N.Ciliberti A. 1987 Alcuni
osservazioni sulla biologia fiorale e di
fruttificazione dell’ olivo. Ann. L’Olivicoltura
Dell’Ist.Sper.Per Vol.IX, Cosenza.
7. Thomaj F., Panajoti Dh. 1998; Aspette
morfofiziologjike të lules së ullirit (*Olea europea*
L.) *Bul.Shk. Bujq.* 1.

QUALITATIVE CHARACTERISTICS OF FOREIGN DURUM WHEAT GENETIC MATERIALS OF UBT

KARAKTERISTIKAT CILËSORE TË MATERIALEVE TË HUAJA GJENETIKE TË GRURIT TË FORTË TË KOLEKSIONIT TË UBT-SË

VALENTINA ARAPI^a, AFËRDITA KASMI^a, VLADIMIR BANO^b, VJOLLCA IBRO^b

^aUniversiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Kamëz, Tiranë, SHQIPËRI

^bUniversiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Kamëz, Tiranë, SHQIPËRI

Email: valiarapi@albaniaonline.net

AKTET IV, 1: 130-135, 2011

PERMBLEDHJE

Në koleksionin e UBT-së ruhen aksesione gruri të vëndit e të huaja, një pjesë e të cilave përdoret si material prindëror për krijimin e linjave të grurit me tipare agronomike krahas atyre cilësore. Për këtë arsye në studimin tonë u zgjodh një pjesë e materialit gjenetik të huaj të grurit të fortë dhe u studjuan disa tregues cilësorë në vitet, 2004-2006. Nga studimi rezultoi një lidhje negative ndërmjet indekseve cilësore dhe atyre të prodhimit, ndërsa ndërmjet përmbajtjes së proteinave dhe glutenit të njomë, rezultuan lidhje pozitive të tipit të fortë. Gjithashtu, ndërmjet përmbajtjes së glutenit, K-SDS, dhe fraksioneve proteinore të tretshme në acid laktik 3.85% dhe KOH 0.5%, rezultuan lidhje pozitive të forta dhe shumë të forta. Duke ju referuar treguesve cilësorë si edhe atyre të prodhimit, vlerësohen si më të mirat aksionet 29, 21, 27, 33, 22.

Fjalët kyçe: Aksesione, tregues cilësorë, tregues biomorfologjikë.

SUMMARY

In the genetic materials' collection of UBT, domestic and foreign wheat accessions are employed as a parent material for the creation of soft and durum wheat lines with agronomic and qualitative features. Therefore, in our study we selected part of this foreign genetic material of durum wheat, and evaluated some qualitative indicators for years, 2004-2006. The results revealed a negative correlation between the qualitative indexes and those of the production, whereas between protein and gluten content there are strong positive correlations. Moreover, there are strong and very strong positive correlations between the content of gluten, K-SDS and the fractions of proteins soluble in lactic acid 3.85% and KOH 0.5%. Based on the qualitative and productive results in our study, we conclude that the numbers 29, 21, 27, 33, 22 are characterized by the best qualitative indexes apart from the bio-morphological ones.

Key words: accession, qualitative index, bio-morphological index.

HYRJE

Gruri ka shoqëruar njërëzit që nga kohët e largëta në evolucionin dhe zhvillimin e tyre, duke u zhvilluar edhe vetë nga format primitive të tij (gruri emmer) në speciet e kultivuara në ditët e sotme.

Struktura e kokrrave ashtu si përbërja kanë kontribuar gjërësisht në përdorimin e grurit si

ushqim i pranueshëm, i shijshëm e me vlera të larta energjetike (2, 8). Punime të shumta kërkimore i janë kushtuar natyrës së faktorit të cilësisë së grurërave, të cilat bazohen kryesisht në vlerësimin e përmbajtjes së vetive të proteinave qoftë me testë të drejtpërdrejta (përmbajtja e glutenit, koeficientit të sedimentimit etj), qoftë të tërthorta nga përcaktimi i vetive reologjike të

brumrave nga mielli i grurit (provat alveografike, falling number etj) si dhe provat e bukëpjekjes (1, 7, 10).

Kështu, objekt i këtij studimi është vlerësimi i karakteristikave cilësore të disa materialeve gjenetike të grurit të fortë të koleksionit të UBT, me qëllim përzgjedhje për cilësi, e për t'i rekomanduar ato si materiale prinndërore në krijimin e linjave e kultivarëve të grurit të butë e të fortë me karakteristika të larta cilësore krahas atyre agronomike.

MATERIALI DHE METODA

Në 35 aksione të huaja të grurit të fortë të koleksionit të UBT, të mbjella në parcelat eksperimentale të EDE-Valias, gjatë viteve 2004-2006, u analizuan treguesit e më poshtëm cilësorë:

Përmbajtja e lagështirës me metoden e tharjes në thermostat në temperaturën 105-110°C deri në peshë konstante (5), përmbajtja e proteinave të përgjithshme sipas metodës së Kjeldahl-it (Nx 5.7), fraksioneve proteinore të tretëshme në ujë, alkal izopropilik 40%, acid laktik 3.85%, KOH 0.5% (5,6), e glutenit të njomë (5), e koeficientit të sedimentimit (4), hirit (5), lartësia e bimës, pesha e 1000 kokrrave, prodhimtaria (9).

Përpunimi statistikor i të dhënave të treguesve cilësorë të materialit gjenetik të grurit të fortë të marrë në studim u krye në Departamentin e Informatikës të UBT.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Në grafikun Nr 1 jepen të dhëna të disa treguesve biomorfologjikë e të prodhimit në 35 aksione të huaja të grurit të fortë të koleksionit të UBT. Treguesi i prodhimit luhatët nga 14.20-43.52 kv/ha (aksionet 9, 29), pra në vlera të ulëta deri mesatare, me një mesatare prej 31.00 kv/ha (Pasqyra Nr 1). Dallojnë për tregues më të lartë të prodhimtarisë aksionet 29, 21, 24, 17, 4 dhe 25. Pesha e 1000 kokrrave luhatët nga 30 gr- 50 gr (aksionet 9, 29) me një mesatare 39.86 gr, një vlerë kjo relativisht e ulët në krahasim me vlerën mbi 55 gr, që është karakteristikë për grurërat e fortë cilësorë (9). Vihet re një lidhje positive e tipit të fortë midis peshës së 1000

kokrrave dhe rendimentit ($r = 0.82$). Lartësia e bimës luhatët nga 72-135 cm (aksionet 1, 24) me një mesatare 94 cm dhe cikli vegetativ luhatët nga 201-205 ditë. Ndërmjet lartësisë së bimës dhe peshës së 1000 kokrrave si dhe lartësisë së bimës dhe rendimentit ekzistojnë lidhje të dobta të pa vërtëtuara statistikisht.

Në Pasqyrën Nr 1 jepen të dhëna të disa treguesve cilësorë në 35 aksione të huaja të grurit të fortë të koleksionit të UBT.

Përmbajtja e proteinave luhatët mesatarisht nga 13.32-17.96% (aksionet 25,9), me një mesatare 14.83%, pra në vlera të larta, ku dallojnë aksionet 9 dhe 27 me 17.96% dhe 16.51% proteina, e më pas renditën 13 aksione me mbi 15% proteina, 15 aksione me mbi 14% proteina dhe 5 aksione me mbi 13% proteina. Ndërmjet treguesve të përmbajtjes së proteinave e të prodhimit vihet re një lidhje negative e tipit të mirë ($r = - 0.53$) dhe një lidhje negative e tipit të dobët midis proteinave dhe peshës së 1000 kokrrave. Gjithashtu, vihen re lidhje positive të tipit të dobët ndërmjet proteinave e ciklit vegetativ, si dhe ndërmjet këtyre të fundit e lartësisë së bimës.

Përmbajtja e glutenit të njomë luhatët mesatarisht nga 23.70-33.83% (aksionet 25,27), pra nga vlera të ulëta deri të larta me një mesatare 27.56%, që i përgjigjet vlerave mesatare të përmbajtjes së glutenit. Dallojnë për vlera të larta të këtij treguesi (mbi 28%) 14 aksione dhe 12 për vlera mesatare (26-28%). Ndërmjet përmbajtjes së proteinave dhe glutenit të njomë rezultojnë një lidhje positive e tipit shumë të mirë ($r = 0.79$). Vlerat mesatare të raportit Gluten\Proteinë luhatën nga 1.668 – 2.110 (aksionet 6,29) me një mesatare 1.857 (7, 11)

Koeficienti i Sedimentimit, K-SDS luhatët mesatarisht nga 23-42.33 ml (aksionet 24,1), pra nga vlera të ulëta deri të mira me një mesatare 30.99 ml që i përgjigjet vlerave mesatare të këtij treguesi. Konstatohet se ndërmjet treguesve të përmbajtjes së proteinave dhe K-SDS si dhe glutenit e K-SDS rezultojnë lidhje të dobta të pavërtëtuara statistikisht, që i detyrohet shpesh përmbajtjes së lartë të

proteinave, mbi 14% (1, 4). Raporti K-SDS\ Proteinë, si tregues më i dukshëm i cilësisë së proteinave, pavarësisht përmbajtjes së lartë të proteinave, luhatet në vlera të ulëta nga 1.591-

2.955 (aksesionet 24,30), në krahasim me vlerën 6.35 që rezulton për grurëra me cilësi të mira të proteinave (3, 4).

Nr	Materialet gjenetike lloji i grurit të fortë të koleksionit të UBT	Rendimen lv/ba	Laj. %	Prot. ndaj lthate %	Gjt. i njome %	K-SDS ml	Gjt / Prot	K-SDS / Prot	Lmin ndaj lthate	Fraks. proteinore (në % ndaj prot.) të tret. në:			
										H ₂ O	Alkizop 40%	Acid laktik 3.85%	KOH 0.5%
1	Jori C 69	22.93	13.80	14.87	29.40	42.33	1.978	2.847	1.71	21.77	19.91	29.88	20.96
2	Sensator Capelli	27.33	13.67	14.35	24.39	37.00	1.700	2.579	1.81	24.47	22.53	27.48	17.83
3	Limno (S - 5770)	35.20	13.37	14.21	26.17	25.67	1.841	1.806	2.14	25.92	23.32	28.29	14.68
4	Graecum	41.30	13.53	13.64	23.72	36.00	1.740	2.649	1.97	24.54	22.31	27.02	18.10
5	Bektra (S - 58120)	39.60	13.53	13.85	24.10	34.00	1.740	2.455	2.17	25.52	22.44	26.58	17.82
6	Melanopus 22A	14.61	13.73	14.61	24.44	30.33	1.668	2.072	1.74	26.58	24.06	26.24	15.63
7	GRS (Limnos)	31.02	13.43	14.05	24.58	33.33	1.753	2.380	1.59	24.87	22.71	27.56	17.13
8	Capelli	39.20	13.20	14.50	24.41	32.67	1.685	2.259	1.67	25.95	23.01	27.00	16.54
9	Trisakria	14.20	13.27	17.96	31.31	32.00	1.743	1.781	1.85	26.04	23.17	28.39	16.38
10	Tito	17.85	13.33	15.54	27.19	33.00	1.750	2.123	2.11	25.82	22.89	28.16	16.21
11	Valgorgio	34.98	13.40	15.11	27.63	26.67	1.831	1.766	1.90	25.15	22.94	28.77	15.90
12	KastelPociano	27.60	13.33	15.25	30.12	29.67	1.976	1.947	1.77	23.70	21.51	30.29	17.34
13	KastelDekmade	28.80	13.10	14.51	27.05	34.33	1.865	2.360	1.88	24.02	21.09	29.04	18.38
14	Lambro	33.44	13.23	14.47	27.01	25.67	1.867	1.774	1.76	24.54	23.28	28.94	15.72
15	Sosonete	24.28	13.38	15.05	29.02	32.33	1.926	2.149	1.88	24.28	20.83	29.66	17.96
16	Montanari B	28.00	13.63	15.36	28.21	37.33	1.838	2.419	2.07	24.43	21.45	28.78	18.20
17	Duro A	41.60	13.30	14.19	27.40	24.00	1.933	1.692	1.90	25.04	22.26	29.55	15.42
18	Duro B	33.44	13.20	14.83	27.41	28.00	1.851	1.888	2.06	25.36	21.67	28.87	16.78
19	Gerardo 529	21.53	13.23	15.23	28.22	30.33	1.853	1.993	2.20	25.10	21.91	28.70	17.14
20	Makani 11C	34.00	13.17	13.64	24.66	24.00	1.808	1.759	2.07	26.00	22.91	28.22	14.89
21	Gerardo 620	42.53	13.40	14.56	28.38	29.33	1.951	2.019	2.02	24.83	21.07	29.67	16.93
22	Duro	36.23	13.47	15.42	29.46	26.33	1.909	1.707	2.07	24.88	22.70	29.57	15.76
23	Makani 81D	25.96	13.63	15.15	26.39	34.00	1.741	2.242	2.23	24.96	22.15	27.76	17.89
24	Makani 12D	42.11	13.47	14.50	26.22	23.00	1.810	1.591	1.90	25.96	24.07	27.91	14.52
25	Ador 1	40.00	13.15	13.32	23.70	29.33	1.785	2.211	2.05	25.02	21.61	27.82	17.35
26	Valfiora	21.85	13.30	13.90	25.30	30.67	1.820	2.208	2.02	24.93	21.41	28.03	17.66
27	Priobara	36.00	13.47	16.51	33.83	34.67	2.049	2.102	2.33	23.27	20.85	31.28	17.89
28	Dritto	34.00	13.20	14.84	27.65	28.33	1.865	1.913	1.91	25.40	22.30	28.74	16.14
29	Bellagio	43.52	13.27	15.30	32.27	32.67	2.110	2.138	2.08	22.64	28.22	31.67	18.24
30	Agathe	37.92	13.57	14.06	26.27	41.00	1.864	2.955	2.10	22.02	18.39	29.06	21.63
31	Trisakcio	24.06	13.23	15.26	32.01	26.00	2.097	1.706	2.24	23.90	21.09	31.72	16.00
32	Kresita	22.80	13.33	15.31	29.62	26.33	1.934	1.720	2.25	24.65	22.65	29.86	15.63
33	Polesita	36.00	13.28	15.90	30.18	36.67	1.898	2.304	2.14	24.09	21.01	29.29	18.69
34	GR 0367	25.41	13.43	14.01	27.09	25.67	1.933	1.833	2.19	24.35	21.71	30.04	16.02
35	Raberi	25.89	13.27	15.79	29.77	32.00	1.885	2.029	2.22	24.66	21.95	29.31	17.09
	Mesatarja	31.00	13.38	14.83	27.56	30.99	1.857	2.097	2.00	24.70	22.01	28.83	17.04

Pasqyra 1. Përmbajtja e prodhimtarisë dhe vlerat mesatare 3 vjeçare të treguesve kimiko-teknologjikë në 35 aksionet e huaja të grurit të fortë të koleksionit të UBT-së


Lënda minerale luhatet mesatarisht nga 1.59-2.33% (aksesionet 7,27) me një mesatare 2%, që i përgjigjet vlerave normale të këtij treguesi.

Proteinën	DMV	0.6758	a=0.01
	DMV	0.5358	a=0.05
Glutenin	DMV	1.9202	a=0.01
	DMV	1.5224	a=0.05
K-SDS	DMV	3.8523	a=0.01
	DMV	3.0542	a=0.05
Për fraks.prot.të tret. në ujë(në % ndaj prot.)	DMV	0.855	a=0.01
	DMV	0.6858	a=0.05
Për fraks.prot.të tret. në Alk.izopr.40% (në	DMV	0.8692	a=0.01
	DMV	0.6892	a=0.05
Për fraks.prot.të tret. në Ac.Laktik 3.85% (në %	DMV	0.9933	a=0.01
	DMV	0.7876	a=0.05
Për fraks.prot.të tret. në KOH 0.5% (në % ndaj	DMV	1.2742	a=0.01
	DMV	1.0102	a=0.05

Pasqyra 2. DMV-të për dy nivelet e rëndësisë për të gjithë treguesit cilësorë





Përmbajtja mesatare e fraksioneve proteinore (në përqindje ndaj proteinës) në 35 aksesionet e huaja të grurit të fortë të koleksionit të UBT, jepet në Pasqyrën 2. Nga të dhënat vërehet, se përmbajtja mesatare e fraksionit uxor (në % ndaj proteinës) luhatët nga 21.77-26.58% (aksesionet 1, 6) me një mesatare 24.70%, e fraksionit të tretshëm në alkol izopropilik 40 % luhatët nga 19.39-24.07% (aksesionet 30, 24) me një mesatare 22.01%, e fraksionit të tretshëm në acid laktik 3.85% luhatët nga 26.24-31.72% (aksesionet 6,31) me një mesatare 28.83%, e fraksionit të tretshëm në KOH 0.5% luhatët nga 14.52-21.63% (aksesionet 24, 30) me një mesatare 17.04%.

Nga studimi i lidhjeve ndërmjet treguesve të përmbajtjes së proteinave, glutenit, K-SDS dhe katër fraksioneve proteinore (në % ndaj proteinës) vërehet një lidhje e tipit mesatar ($r=0.40$) ndërmjet fraksionit proteinor të tretshëm në acid laktik 3.85% dhe proteinës, si dhe një lidhje e tipit të fortë me glutenin ($r = 0.86$), ndërsa ndërmjet fraksionit të tretshëm në KOH 0.5% dhe K-SDS rezulton një lidhje e tipit shumë të fortë ($r = 0.90$).



Grafiku 1. Materialet gjenetike të huaja të grurit të fortë

FrakSIONET e tjera tregojnë lidhje të dobëta me proteinën, glutenin dhe K-SDS, çka tregon ndikimin e papërfillshëm të tyre në këta tregues (6).



Grafiket 2-5.

Duke parë me kujdes analizën e variancës me një faktor (faktori vit) për të gjithë treguesit cilësorë të studiuar në 35 aksesionet e huaja të grurit të fortë, vihen re ndryshime të rëndësishme të vlerave vetëm për treguesin e K-SDS dhe ndryshime shumë të rëndësishme për treguesit e fraksioneve proteinore (në % ndaj proteinës) të tretëshme në ujë, në alkol izopropilik 40 %, në acid laktik 3.85% dhe në KOH 0.5 %. Për treguesit e tjerë nuk vihen re ndryshime esenciale të vlerave të tyre gjatë tri viteve të studimit. Vihet re gjithashtu, se në të gjitha rastët kur ka ndikuar faktori vit, ka qënë niveli viti 2004 që ka influencuar në ndikimin e faktorit vit në madhësinë “ndryshime esenciale të vlerave të treguesve cilësorë”. Duke u nisur nga ANOVA në pasqyrën 2, tregohen DMV-të për dy nivelet e rëndësisë, për të gjithë treguesit cilësorë të analizuar.

PËRFUNDIME

-Përbajtja mesatare e proteinave në 35 aksesionet e huaja të grurit të fortë të koleksionit të UBT-së luhatet nga 13.32-17.96% (aksesionet 25,9) me një mesatare 14.83%, pra në vlera të larta.

-Përbajtja e glutenit të njomë luhatet mesatarisht nga 23.70-33.83% (aksesionet 25, 27), pra nga vlera të ulëta deri të larta me një mesatare 27.56%, që i përgjigjet vlerave mesatare të këtij treguesi.

-Vlerat e koeficientit të sedimentimit – SDS luhaten mesatarisht nga 23-42.33 ml (aksesionet 24, 1), pra nga vlera të ulëta deri të mira me një mesatare 30.99 ml që i përgjigjet vlerave mesatare të K-SDS.

-Përbajtja e fraksionit proteinor të tretshëm në KOH 0.5% (në % ndaj proteinës) luhatet mesatarisht në vlera të ulëta.

-Ndërmjet peshës së 1000 kokrrave dhe rendimentit rezultojnë një lidhje pozitive e tipit të fortë (r = 0.82).

-Ndërmjet përbajtjes së proteinave dhe glutenit të njomë rezultojnë një lidhje pozitive e tipit shumë të mirë (r = 0.79).

-Ndërmjet glutenit dhe fraksionit proteinor të tretshëm në acid laktik 3.85% rezultojnë një lidhje pozitive e tipit të fortë (r = 0.86).

-Ndërmjet K-SDS dhe fraksionit proteinor të tretshëm në KOH 0,5% rezulton një lidhje pozitive e tipit shumë të fortë ($r = 0.90$).

-Nga analiza e variancës me një faktor (faktori vit) për të gjithë treguesit cilësorë të studiuar në 35 aksione të huaja të grurit të fortë, vihen re ndryshime të rëndësishme të vlerave vetëm për treguesin e K-SDS dhe ndryshime shumë të rëndësishme për katër treguesit e fraksioneve proteinore (në % ndaj proteinës).

REKOMANDIME

Nga vlerësimi krahasues i treguesve cilësorë si dhe atyre të prodhimit në 35 aksione të huaja të grurit të fortë të koleksionit të UBT, do të rekomandonim aksionet 29, 21, 27, 33, 22, që karakterizohen me tregues të lartë cilësorë dhe të kënaqshëm të prodhimit, për t'u ruajtur në fondin gjenetik si material prindëror për krijimin e linjave të grurit të fortë me tipare agronomike krahas atyre cilësore.

BIBLIOGRAFIA

1. AACC International 2000. Approved methods 10th ed. Available at [www.Aaccnet.org/ Approved methods/](http://www.Aaccnet.org/Approved%20methods/) to phtml (accessed Aug. 2004, March 2005, verified 31 Jan. 2006). Am. Assoc. of Cer. Chemists Int, St Paul. MN.
2. Boskov Hansen H., Andreasen M.F., Nielsen M.M., Larsen L.M., Bach Knudsen K.E., Meyer A.S., Christensen L.P., Hansen A. (2002) Eur Food Res Technol 214, 33-42

3. Boyacioglu M.H., D'Apollonia B.L. (1994) "Characterization and utilization of durum wheat for bread making. Staling properties of bread baked from wheat flours and durum wheat flours." *Cereal Chem.* 71; 34-41
4. Dick J.W., Quick J.S. (1983) *cereal Chem* 60; 315-318.
5. Frashëri M., Bimbashi H., Analizat e produkteve ushqimore.
6. Hamada A.S., Donald C.E., and Sibitt I.D., "Relationships of Protein fraction of spring wheat flour to baking quality" *Cereal Chm.* 59(4) pp. 296-301.
7. Kuktaite R., Johansson E., Juodeikiene G. (2000), Composition and concentration of protein in Lithuanian wheat cultivars: relation with bread-making quality". *Cereales. Comm.* 288: 195-202.
8. Pasqualone A., Blanco A., Simone R., Fares C., (2002) "Valutazione della qualita panificatoria di cultivari di frumento duro nella produzione del Pane di Altamura" *Tecnica Molitoria* p: 770-779.
9. Përmeti M (2002) "Biologjia e Grurit"
10. Shellenberger I.A., D'Apollonia B.L., and Gilles K.A., Elisabeth M., Osman, Y. Pomeranz, Gerland Reed "Wheat chemistry and Technology" (Monograph series) p. 3-19, 230-250.
11. Weegels P.L., Hammer R.I. and Schofield I.D. (1996) "Critical review, functional properties of wheat glutenin". *I.Cereal Sci* 23: 1-18.

MORPHOBIOLOGICAL STUDY OF SOME VEGETATIVE ROOTSTOCKS OF APPLE IN ALBANIA STUDIMI MORFOLOGJIK I DISA NËNSHARTESAVE VEGJETATIVE TË MOLLËS NË SHQIPËRI

HAFUZ DOMI¹, FADIL THOMAJ², TELAT SPAHIU³.

^{1,3}- ADAD, Dibër, Shqipëri

²Departamenti Hortikulturë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri

AKTET IV, 1: 136-141, 2011

PERMBLEDHJE

Mbjellja e pemëtoreve intensive tashmë është kthyer në një tendencë të përgjithshme në vendin tonë. Në rastin konkret, prodhimi i fidanëve cilësorë të mollës kërkon njohjen e mirë të nënshartësave më të përshtatshme për zonën (1, 3, 5, 7, 9). Kjo kërkon njohjen e karakteristikave të nënshartësave vegjetative ndaj kushteve klimatiko-tokësore dhe në kombinimet me kultivarët përkatës. Nëpërmjet këtij studimi synuam njohjen me sjelljen e disa nënshartësave të reja për vendin tonë në kushtet e ekosistemit të zonës së Korçës dhe Dibrës si dy zonat parësore të mollës. Në analizë u morën numri i vëllezërve, lartësia e tyre, diametri i tyre, uniformiteti i lastarëve, numri i rrënjëve skeletore, prania e gungave mbi lastar etj. Nga të dhënat e përfuara rezultoi se numri i rrënjëve që formojnë luhatet midis 3-7; MM106 dhe Pajam 2, formojnë rrënjë skeletore më të fuqishme. Gjithashtu ekziston një lidhje pozitive midis numrit të gungave dhe gjatësisë së ndërnjësve.

Fjalë kyçe: nënshartësë, ekosistem, hiperplazi, lastar, rrënjë.

SUMMARY

In this case, the production of quality seedlings of apple requires a knowledge of the best suited rootstocks for the area (1, 3, 5, 7, 9). This requires to know the characteristics of vegetative rootstocks brought, their behavior towards climatic-terrestrial conditions and in the combination with the respective cultivars. Through this study we aimed being familiar with the behavior of some new rootstocks for our country in terms of the ecosystem of the area of Korça and Dibra as two primary areas of apple. We analysed the number of brothers, brothers height, diameter of the brothers, uniformity of branches, number of skeletal roots, the presence of bumps. The data obtained showed that the number of formed roots ranges from 3 to 7, MM106 and Pajama 2, form the most powerful skeletal roots, there is a positive relation between the number of biological bumps and length of inter-nodes, which affects negatively on the technique of grafting.

Key words: rootstock, ecosystem, hyperplasia, spray, root.

HYRJE

